



B a n k a e S h q i p ë r i s ë

B U L E T I N I Z Y R T A R

vëllimi 21, numër 4, qershor 2019

BANKA E SHQIPËRISË

B U L E T I N I
Z Y R T A R

vëllimi 21

numër 4

Qershor 2019

Data e botimit: 13.06.2019

P Ë R M B A J T J A

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 37, datë 8.5.2019 "Për miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 78, datë 08.12.2004, "Për miratimin e "Kritereve për caktimin e çmimeve të shitjes për kartëmonedhat dhe monedhat metalike, vlera të tjera numizmatike, ambalazhe dhe katalogë", si dhe të "Metodikës për llogaritjen e çmimeve të shitjes së kartëmonedhave e monedhave metalike me dhe pa kurs ligjor, si dhe për katalogun e tyre"" 7
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 40, datë 8.5.2019 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë" 10
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 41, datë 5.6.2019 "Për miratimin e rregullores "Për shtesat makroprudenciale të kapitalit"" 12
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 42, datë 5.6.2019 "Për revokimin e licencës së Bankës së Kreditit të Shqipërisë sh.a." 45
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 44, datë 5.6.2019 "Për miratimin e rregullores "Vlerësimi për qëllimet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme"" 46
6. Urdhër i Guvernatorit nr. prot. 2973, datë 7.6.2019 "Për hedhjen në qarkullim të monedhës metalike shqiptare, me kurs ligjor, me vlerë nominale 10 Lekë" 72
7. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar vëllimi 21, numër 1, shkurt 2019 73
8. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar vëllimi 21, numër 2, mars 2019 74
9. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar vëllimi 21, numër 3, prill 2019 74



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM
Nr. 37, datë 8.5.2019

PËR
MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË VENDIMIN E KËSHILLIT
MBIKËQYRËS NR. 78, DATË 08.12.2004, "PËR MIRATIMIN E "KRITEREVE
PËR CAKTIMIN E ÇMIMEVE TË SHITJES PËR KARTËMONEDHAT DHE
MONEDHAT METALIKE, VLERA TË TJERA NUMIZMATIKE, AMBALAZHE
DHE KATALOGË", SI DHE TË "METODIKËS PËR LLOGARITJEN E ÇMIMEVE
TË SHITJES SË KARTËMONEDHAVE E MONEDHAVE METALIKE ME DHE PA
KURS LIGJOR, SI DHE PËR KATALOGUN E TYRE"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; si dhe me propozimin e Departamentit të Kërkimeve, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI

1. Në shtojcën nr. 1 "Për miratimin e "Kritereve për caktimin e çmimeve të shitjes për kartëmonedhat dhe monedhat metalike, vlera të tjera numizmatike, medaljonet përkujtimore, ambalazhe dhe katalogë", dhe "Metodikën për llogaritjen e çmimeve të shitjes së kartëmonedhave e monedhave metalike me dhe pa kurs ligjor, si dhe për katalogun e tyre", miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 78, datë 08.12.2004, i ndryshuar, të bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:
 - a. Përmbajtja e pikës nr. 2.6 ndryshon si vijon:

""Katalogë ndërkombëtarë" nënkupton katalogët standardë ndërkombëtarë të kartëmonedhave dhe monedhave: "World Paper Money" dhe "World Coins", të botuara nga Krause Publications, ose botime të ngjashme, të cilat përdoren gjerësisht nga shoqëritë numizmatike.";
 - b. Pikat 4, 5, 6 rinumërohen përkatësisht si pika 3, 4, dhe 5, si dhe nën pikat e tyre sipas numërimit të ri;

c. Përmbajtja e pikës nr. 3.1 ndryshon si vijon:

“Çaktimi i çmimeve të shitjes së kartëmonedhave dhe monedhave metalike që nuk kanë kurs ligjor, bëhet mbi bazën e katalogëve më të fundit ndërkombëtarë të kartëmonedhave dhe të monedhave metalike.”;

d. Përmbajtja e pikës nr. 3.2 ndryshon si vijon:

“Në rastet kur çmimet e nënkategorive sipas përkufizimit në pikën 2.2 të kësaj shtojce mungojnë, çmimi i shitjes së vlerave numizmatike sipas nënkategorive, përcaktohet i diferencuar ndaj çmimit të shkallës UNC (ose duke ruajtur shkallëzimin) si vijon:

- a) për shkallën XF, jo më pak se 80 për qind e çmimit të publikuar ose të llogaritur UNC;
- b) për shkallën VF, jo më pak se 65 për qind e çmimit të publikuar ose të llogaritur XF;
- c) për shkallën F, jo më pak se 55 për qind e çmimit të publikuar ose llogaritur VF;
- d) për shkallën VG, jo më pak se 45 për qind e çmimit të publikuar ose llogaritur F.”;

e. Shkronja “a” e pikës 3.4.1 shfuqizohet;

f. Në pikën 3.4, 3.4.2 dhe pikën 5.2 hiqet shprehja “pas vitit 2000”;

g. Pika e dytë 3.4.2 shfuqizohet;

h. Pas pikës 3.4.2 shtohet pika 3.4.3 me përmbajtje si vijon:

“Çmimi i shitjes së monedhave metalike përkujtimore me material ar dhe argjend, të cilat janë të publikuara në katalogët standardë ndërkombëtarë të monedhave, do të jetë i barabartë me vlerën më të lartë që rezulton nga krahasimi i:

- a) vlerësimin maksimal të katalogut;
- b) vlerës për peshën në ar dhe argjend të monedhave, të llogaritur në bazë të kursit fiks të arit dhe argjendit në Tregun e Londrës, në ditën e fundit të punës të çdo muaji;
- c) 150% të vlerës kontabël të secilës monedhë.”;

i. Pas pikës 3.4.3 shtohet pika 3.4.4 me përmbajtje si vijon:

“Çmimi i shitjes së monedhave përkujtimore me metal të thjeshtë, të cilat janë publikuar në katalogët ndërkombëtarë, do të jetë i barabartë me vlerën më të lartë që rezulton nga krahasimi i:

- a) vlerësimin maksimal të katalogut;
- b) 300% të vlerës kontabël të secilës monedhë.”.

2. Në shtojcën 2, pasqyra nr. 4 e pikës IV ndryshon sipas pasqyrës bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO

METODIKË PËR LLOGARITJEN E ÇMIMEVE TË SHITJES TË KARTËMONEDHAVE DHE MONEDHAVE METALIKE ME DHE PA KURS LIGJOR

Në shtesë të shtojcës nr. 2, të vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 78, datë 08.12.2004 (miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 65, datë 14.09.2011)

IV. Për caktimin e çmimeve të shitjes së monedhave metalike me metal ar dhe argjend, do të veqrohet sipas metodikës së treguar në pasqyrën nr.4.

| Emërtimi i monedhave | Pesha e monedhës në g/ 1 copë (sipas katalogut) | Pastërtia për/1000 (sipas katalogut) | Pesha neto në g/1 copë 4=2 x 3 | Pesha e kthyer në ONC 5 = 4 : 31.10348 | Vlera për peshën në Usd | | Vlera për peshën në Lek 7=6 x kursin Usd/Lek | Vlerësimi në katalog (më i fundit) x kursin Usd/Lek | 150% e vlerës kontabël | Çmimi i proponuar për shitje (në Lek) |
|----------------------|---|---|--------------------------------------|---|----------------------------|---|---|--|---------------------------|---|
| | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 6 | 7 | 8 | 9 | më i madhi midis 7, 8 dhe 9 |
| 1 | | | | | | | | | | |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM
Nr. 40, datë 8.5.2019

PËR
MBAJTJEN E PANDRYSHUAR TË NORMËS SË INTERESIT TË
MARRËVESHJEVE TË RIBLERJES DHE TË ANASJELLA TË RIBLERJES DHE
TË NORMAVE TË INTERESIT TË DEPOZITËS NJËDITORE DHE TË KREDISË
NJËDITORE NË BANKËN E SHQIPËRISË

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronjat "a" dhe "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Politikës Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 1.00 për qind, normën e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes (REPO dhe REPO të anasjella).
2. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 0.1 për qind, normën e interesit që Banka e Shqipërisë i paguan një banke tregtare për depozitën njëditore.
3. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 1.9 për qind, normën e interesit që një bankë tregtare i paguan Bankës së Shqipërisë për kredinë njëditore.
4. Ngarkohet Departamenti i Operacioneve Monetare të njoftojë menjëherë bankat tregtare për këtë vendim.
5. Ngarkohen Departamenti i Operacioneve Monetare dhe të gjitha strukturat e tjera në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në faqen zyrtare të internetit dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM
Nr. 41, datë 5.6.2019

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR SHITESAT MAKROPRUDENCIALE TË KAPITALIT”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, dhe nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të nenit 66/1 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe të vendimit nr. 38, datë 02.08.2017, “Për miratimin e strategjisë së politikës makroprudenciale”; me propozim të Departamentit të Stabilitetit Financiar; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për shtesat makroprudenciale të kapitalit” sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Stabilitetit Financiar, Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Statistikave Financiare, për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO

Neni 1 Objekti i rregullores

- (1) Objekti i rregullores:
- (a) është të përcaktojë mënyrën e zbatimit të secilës prej shtesave makroprudenciale të kapitalit dhe të kombinimit të tyre; dhe
 - (b) nuk është të tregojë mënyrën se si secila nga shtesat makroprudenciale të kapitalit dhe kombinimi i tyre, ndërveprojnë me kërkesat për instrumentet e kapitalit dhe të detyrimeve të pranuar sipas ligjit nr. 133/2016 "Për ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë" (më tej, ligji nr. 133/2016).
- (2) Zbatimi i këtyre shtesave makroprudenciale të kapitalit nuk ndalon dhe as kufizon zbatimin e masave të tjera mbikëqyrëse mbi subjektet e rregullores.

Neni 2 Subjektet e rregullores

Sipas përcaktimeve në këtë rregullore, Banka e Shqipërisë zbaton secilën nga shtesat makroprudenciale të kapitalit:

- (a) potencialisht, mbi secilën nga bankat e licencuara prej saj;
- (b) në nivel institucioni (të veçantë) dhe/ose në nivel të konsoliduar, sipas një njoftimi specifik që i bëhet bankës për këtë qëllim, ku përcaktohet edhe se ku do të mbahet (kontabilizohet) vlera e shtesave makroprudenciale të kapitalit. Mbajtja e shtesave makroprudenciale të kapitalit orientohet sipas matricës në Aneksin 1 dhe në rastet konkrete, mund të përcaktohet mbështetur në komunikimin paraprak të Bankës së Shqipërisë me autoritetin e huaj përgjegjës.

Neni 3 Baza ligjore

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të:

- (a) nenit 12, shkronja "a", dhe nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar (më tej, ligji nr. 8269/1997);
- (b) nenit 66/1 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (më tej, ligji nr. 9662/2006);
- (c) nenit 8 të rregullores nr. 19, datë 29.02.2016, "Mbi organizimin dhe funksionimin e Departamentit të Stabilitetit Financiar";
- (ç) vendimit nr. 38, datë 02.08.2017, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë "Për miratimin e Strategjisë së Politikës Makroprudenciale".

Neni 4 Përkufizime

- (1) Në këtë rregullore, termat e mëposhtëm kanë kuptimet më poshtë.
1. **Banka** - ka kuptimin sipas ligjit nr. 9662/2006.
 2. **Kapitali bazë i nivelit të parë** - ka kuptimin sipas nenit 6 të rregullores nr. 69, datë 18.12.2014, "Për kapitalin rregullator të bankës", e ndryshuar (më tej, "rregullorja 69/2014"). Në këtë rregullore do të shënohet me akronimin "KBN1".
 3. **Raporti i KBN1** - Është raporti i vlerës së KBN1-së ndaj ekspozimeve të ponderuara me rrezikun (përcaktuar sipas nënparagrafit 22), i shprehur në përqindje. Në këtë rregullore do të shënohet me akronimin "KBN1r".
 4. **Kapitali i nivelit të parë** - ka kuptimin sipas nenit 6 të rregullores 69/2014. Në këtë rregullore do të shënohet me akronimin "KN1".
 5. **Raporti i KN1** - është raporti i vlerës së KBN1-së ndaj ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, i shprehur në përqindje. Në këtë rregullore do të shënohet me akronimin "KN1r".
 6. **Kapitali rregullator** - ka kuptimin sipas nenit 6 të rregullores 69/2014. Në këtë rregullore do të shënohet me akronimin "KREG".
 7. **Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit** - është raporti i vlerës së KREG-ut ndaj ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, i shprehur në përqindje, sipas nenit 5 të rregullores nr. 48, datë 31.07.2013, "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit", e ndryshuar (më tej, "rregullorja 48/2013"). Në këtë rregullore do të shënohet me akronimin "RMK".
 8. **Kërkesa minimale e kapitalit** - janë kërkesat e detyrueshme për vlerat minimale të KBN1r-së, të KN1r-së dhe të RMK-së, sipas nenit 42 të rregullores 69/2014. Në këtë rregullore do të shënohet me akronimin "KMK".
 9. **Kërkesa të tjera të detyrueshme të kapitalit** - janë kërkesa të detyrueshme për sasinë e kapitalit, të ndryshme nga (dhe zakonisht mbi) KMK-të, sipas përcaktimeve në ligj ose akt nënligjor (për shembull, kërkesa në kuadër të procesit të rishikimit dhe vlerësimit mbikëqyrës dhe kërkesa të tjera në procesin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme në banka në zbatim të ligjit nr. 133/2016).
 10. **Kapitali neto i disponueshëm** - ka kuptimin e KBN1-së së bankës që mbetet pasi pakësohet me shumën e vlerës që nevojitet për të përmbushur:
 - (a) KBN1r, KN1r dhe RMK; dhe
 - (b) kërkesat e tjera të detyrueshme të kapitalit, që zbatohen ndaj bankës, për aq sa ato duhet të përmbushen me instrumente të KBN1-së.Në këtë rregullore do të shënohet me akronimin "KND".
 11. **Raporti i kapitalit neto të disponueshëm** - është raporti i vlerës së KND-së ndaj ekspozimeve të ponderuara me rrezik të bankës, i shprehur në përqindje. Në këtë rregullore do të shënohet me akronimin "KNDR".
 12. **Shtesa konservuese e kapitalit** - është sasia e kapitalit që një bankë

- duhet të mbajë në instrumente të KBN1-së, mbi KMK-në, sipas nenit 10. Ajo shprehet në përqindje, si raport ndaj ekspozimeve të ponderuara me rrezikun të bankës. Në këtë rregullore do të shënohet me akronimin "KONS". Madhësia e shtesës (norma në %) është unike dhe ndikimi i saj është i njëjtë për secilën nga bankat.
13. **Shtesa kundërciklike e kapitalit** - është sasia e kapitalit që një bankë duhet të mbajë në instrumente të KBN1-së, përtej KONS-it, sipas nenit 11. Ajo shprehet në përqindje, si raport ndaj ekspozimeve të ponderuara me rrezik të bankës. Në këtë rregullore do të shënohet me akronimin "KUNC". Madhësia e shtesës (norma në %) është unike, por ndikimi i saj për secilën nga bankat do të varet nga përbërja dhe niveli i ekspozimeve të përshtatshme të kreditit (përcaktuar në nënparagrafin (29)).
 14. **KUNC i aplikuar** - është norma e KUNC-it, e zbatuar në Shqipëri dhe në juridiksione të huaja, e përcaktuar sipas neneve 12 dhe 13. Në këtë rregullore do të shënohet me akronimin "AKUNC".
 15. **KUNC specifik për bankën** - është KUNC-i i llogaritur për bankën, sipas nenit 11. Në këtë rregullore do të shënohet me akronimin "SPEKUNC".
 16. **Bankat me rëndësi sistemike** - Janë bankat e përcaktuara me rëndësi sistemike sipas një metodologjie të caktuar të Bankës së Shqipërisë, në përputhje me nenin 14. Në këtë rregullore do të shënohet me akronimin "BARS".
 17. **Shtesa e kapitalit për bankat me rëndësi sistemike** - është sasia e kapitalit që një BARS duhet të mbajë në instrumente të KBN1-së, përtej KONS-it, sipas nenit 14. Ajo shprehet në përqindje, si raport ndaj ekspozimeve të ponderuara me rrezik të bankës. Në këtë rregullore do të shënohet me akronimin "SIST". Madhësia e shtesës (norma në %) është tërësisht në varësi të rëndësisë sistemike të bankës.
 18. **Shtesa e kapitalit për rrezikun sistematik** - është sasia e kapitalit që një bankë duhet të mbajë në instrumente të KBN1-së, përtej KONS-it, sipas nenit 15. Ajo shprehet në përqindje, si raport ndaj ekspozimeve të ponderuara me rrezik të bankës. Në këtë rregullore do të shënohet me akronimin "STRUK". Mënyra e zbatimit të kësaj shtese ka një shkallë relativisht të lartë fleksibiliteti.
 19. **Shtesa makroprudenciale e kapitalit** - Sipas normave të shpallura të Bankës së Shqipërisë dhe afateve përkatëse, është secila nga shtesat e kapitalit, në kuadër të zbatimit të politikës makroprudenciale për KONS, KUNC, SIST dhe STRUK. Në këtë rregullore do të shënohet me akronimin "SHMAK".
 20. **Shtesa e kombinuar makroprudenciale e kapitalit** - është zbatimi i më shumë se një SHMAK-u në të njëjtën kohë (për shembull, i KONS-it dhe i KUNC-it). Në këtë rregullore do të shënohet me akronimin "SHKOMAK". Nëse zbatohet vetëm një SHMAK (për shembull, KONS-i), atëherë SHMAK-u dhe SHKOMAK-u përfaqësojnë të njëjtën gjë (vlerë).
 21. **Raporti i përmbushjes së SHKOMAK** - është raporti i KNDR-së ndaj SHKOMAK-ut, i shprehur në përqindje.
 22. **Ekspozimet e ponderuara me rrezikun** - janë aktivet e bankës të ponderuara me peshat e rrezikut për qëllimin e llogaritjes së kërkesës

për kapital, sipas rregullores nr. 48/2013. Në këtë rregullore do të shënohet me akronimin "EPR".

23. **Pagesë shpërndarjeje** - për një bankë, ka kuptimin e kryerjes së një pagese ose të krijimit të një angazhimi për pagesë, që shoqërohet me uljen e vlerës së KBN1-së dhe të të ardhurave, dhe që përfshin:

- (a) dividendin;
- (b) blerjen ose shlyerjen e instrumenteve të KBN1;
- (c) instrumentet e kapitalit shtesë të nivelit të parë;
- (ç) shpërblimet apo fondin e pensionit për drejtuesit dhe personelin e institucionit;
- (d) çdo formë tjetër, të ngjashme.

Në kuptimin e kësaj rregulloreje, ulja e nivelit të KBN1-së nuk përfshin rastin kur rrezikohet mospërmbushja e KMK-së sipas rregullores nr. 69/2014, nenit 42, për të cilin banka duhet të veprojë sipas përcaktimeve në atë rregullore.

24. **Të ardhurat** - ka kuptimin e vlerës që llogaritet:

- (a) duke mbledhur së bashku:
 - (i) fitimin e periudhave të ndërmjetme (sipas rregullores nr. 69/2014, neni 6, paragrafët 2 dhe 8), i papërfshirë në KBN1, dhe i gjeneruar që prej kryerjes së pagesës me të fundit të shpërndarjes, dhe
 - (ii) fitimin e llogaritur për fundin e vitit financiar (sipas rregullores nr. 69/2014, neni 6, paragrafët 2 dhe 8), i papërfshirë në KBN1, dhe i gjeneruar që prej kryerjes së pagesës më të fundit të shpërndarjes;

si dhe

- (b) duke zbritur nga vlera e llogaritur sipas pikës (a) çdo taksë apo detyrim tjetër të ngjashëm, që do të duhej të paguhej nëse fitimi i gjeneruar sipas pikës (a) do të ruhej i plotë (retained).

25. **Përqindja maksimale e shpërndarjes** - përcaktohet duke iu referuar kuartilit të normës së SHKOMAK-ut, ku pozicionohet KNDr-ja, siç tregohet në nenin 8, tabela 1.

26. **Vlera maksimale e shpërndarjes** - për një bankë, është prodhimi midis: (a) të ardhurave të bankës sipas nënparagrafit (24); dhe (b) përqindjes maksimale të shpërndarjes sipas nënparagrafit (25).

27. **Periudha paraprijëse** - duke iu referuar vendosjes së shtesës makroprudenciale të kapitalit, është periudha që fillon në ditën vijuese të punës të datës së shpalljes së shtesës makroprudenciale dhe që përfundon në ditën e punës që paraprin datën efektive të shtesës makroprudenciale.

28. **Data efektive** - duke iu referuar SHMAK-ut, nënkupton datën kur ajo nis të zbatohet, pra kur banka duhet të përmbushë SHMAK-un.

29. **Ekspozimi i përshtatshëm i kreditit** - për këtë rregullore dhe duke iu referuar një banke, ka kuptimin e një ekspozimi që njëherazi përmbush përcaktimet në pikat (a) dhe (b), si në vijim:

- (a) është:
 - (i) një ekspozim jo i titullzuar, për të cilin banka llogarit një vlerë kapitali sipas nënparagrafit (30)(a),
 - (ii) një ekspozim i titullzuar, për të cilin banka llogarit një vlerë

- kapitali sipas nënparagrafit (30)(b),
(iii) një ekspozim për të cilin banka llogarit një vlerë kapitali për rrezikun e tregut, sipas nënparagrafit (30)(c);
- b) i cili është dhënë për një subjekt që, si rezultat, ka një detyrim financiar ndaj bankës dhe ku ky subjekt NUK është:
- (i) një qeveri qendrore,
 - (ii) një organizëm qeverisës lokal/rajonar,
 - (iii) një kompani e sektorit publik,
 - (iv) një bankë zhvillimi,
 - (v) një bankë.

Në këtë rregullore do të shënohet me akronimin "EPSHK".

30. **Kërkesa për kapital** – në këtë rregullore:

- a) për EPSHK-të e bankës, sipas nënparagrafit (29)(a)(i), është kërkesa për kapital për rrezikun e kredisë, sipas rregullores nr. 48/2013: neni 6, paragrafi (1)(a), neni 7, paragrafi (2)(a), por duke përjashtuar rrezikun e kreditit të kundërpartisë, si edhe sipas Kreut III;
- b) për EPSHK-të e bankës, sipas nënparagrafit (29)(a)(ii), është kërkesa për kapital sipas rregullores nr. 48/2013, Kreu V;
- c) për EPSHK-të e bankës, sipas nënparagrafit (29)(a)(iii), është kërkesa për kapital për rrezikun e tregut, sipas rregullores nr. 48/2013: neni 6 paragrafi (1)(b), neni 7, paragrafi (2)(b), dhe Kreut VII, ku kërkesa për kapital do të mbulojë vetëm rrezikun specifik në instrumentet e borxhit dhe në instrumentet financiare, vlera e të cilave varet nga faktorë që lidhen me gjendjen individuale të emetuesit, duke përfshirë edhe instrumentet derivativë të kreditit.

Në këtë rregullore do të shënohet me akronimin "KPK".

31. **Rrezik përfundimtar** - sipas kësaj rregulloreje, ka kuptimin e identifikimit të subjektit që mban i fundit rrezikun që shoqëron një EPSHK (për shembull, huamarrësi, në rastin e një ekspozimi të paguarantuar; ose lëshuesi/zotëruesi i garancisë/kolateralit, në rastin e një ekspozimi të garantuar).
32. **Lokalizim i rrezikut përfundimtar** - për qëllimin e identifikimit të AKUNC-it, ka kuptimin e juridiksionit ku është vendosur subjekti që mban i fundit rrezikun e EPSHK-së (që ka detyrimin ndaj bankës).
33. Juridiksioni ku është vendosur subjekti që mban i fundit rrezikun e EPSHK-ve - duke konsideruar më parë pikat (c) dhe (d), ka kuptimin e:
- (a) në rastin kur subjekti është person fizik, juridiksionit ku subjekti është rezident;
 - (b) në rastin kur subjekti është person juridik:
 - (i) juridiksionit ku subjekti është i licencuar/i regjistruar për veprimtarinë e tij, ose
 - (ii) juridiksionit ku është vendosur drejtoria qendrore e administrimit të subjektit, nëse ky juridiksion është i ndryshëm nga ai i nënpikës (i);
 - (c) në rastin kur ekspozimi i kreditit është i specializuar (për shembull në rastin e *project finance*):
 - (i) juridiksionit nga ku gjenerohen të ardhurat kryesore të projektit, ose

- (ii) juridiksionit ku janë të vendosura (të regjistruara) asetet që shërbejnë si kolateral për projektin (nëse ky juridiksion është i ndryshëm nga ai i nënpikës (i);
- d) juridiksionit të bankës ku është kontabilizuar ekspozimi i kreditit ndaj subjektit privat, nëse plotësohet parashikimi i nenit 13, paragrafi (ó).
34. **Juridiksion i huaj** - në këtë rregullore ka kuptimin e një shteti apo territori të ndryshëm nga Shqipëria, ku një bankë e licencuar në Shqipëri ka EPSHK.
35. **Autoriteti përgjegjës i huaj** - ka kuptimin e autoritetit publik në juridiksionin e huaj, i cili ka përgjegjësinë ligjore ose rregullative të vendosë normën e KUNC-it. Kur juridiksioni i huaj është vend që i përket (anëtar i) Zonës Ekonomike Evropiane, atëherë autoriteti përgjegjës mund të jetë Banka Qendrore Evropiane kur ajo vepron në përputhje me rregulloren e Këshillit Evropian nr. 1024/2013, neni 5, paragrafi (2).
36. **Bordi Evropian i Rrezikut Sistemik** - është institucioni që funksionon sipas rregullores nr. 1092/2010 të datës 24.11.2010 të Parlamentit Evropian dhe të mbikëqyrjes makroprudenciale të Këshillit të Bashkimit Evropian për sistemin financiar. Në këtë rregullore do të shënohet me akronimin "BERRS".
37. **STRUK i aplikuar** - është niveli i aplikuar i STRUK-ut, i cili përcaktohet sipas nenit 15. Në këtë rregullore do të shënohet me akronimin "ASTRUK".
- (2) Në këtë rregullore, sa herë përmenden termat "SHMAK", "SHKOMAK", "KONS", "KUNC", "AKUNC", "SPEKUNC", "SIST", "STRUK" dhe "ASTRUK", do të kuptohet, sipas rastit, niveli ose norma në përqindje e secilit prej tyre.

Neni 5 Përjashtime

- (1) Pavarësisht përcaktimit në nenin 2(a), me kërkesë të bankës, Banka e Shqipërisë mund të përjashtojë banka me karakteristika të caktuara nga zbatimi i SHMAK-ut, kur përjashtimi nuk dobëson stabilitetin e sistemit financiar në vend.
- (2) Nëse Banka e Shqipërisë do ta zbatojë përjashtimin sipas paragrafit (1), vendimi i saj:
- (a) do të identifikojë bankën ose bankat që përjashtohen;
- (b) do të jetë i arsyetuar për përzgjedhjen;
- (c) do të shpjegojë përse ky përjashtim nuk dobëson stabilitetin e sistemit financiar në vend.
- (3) Nëse parashikohet ose i shërben angazhimeve të saj në marrëveshjet ndërkombëtare, Banka e Shqipërisë njofton edhe autoritetet e vendeve të tjera, që kanë kompetencën mbikëqyrëse në vendin e origjinës së bankës ose të grupit bankar zotërues të saj, lidhur me përjashtimin sipas paragrafit (1).

Neni 6

Përbërja dhe shprehja e shtesës makroprudenciale të kapitalit (SHMAK) dhe shtesës së kombinuar makroprudenciale të kapitalit (SHKOMAK)

- (1) SHMAK-u:
 - (a) në çdo rast, krijohet dhe mbahet me instrumente të KBN1;
 - (b) shprehet si raport në përqindje ndaj totalit të EPR;
 - (c) shpallet nga Banka e Shqipërisë sipas nenit 17, paragrafi (1).
- (2) Në bazë të shpalljeve të Bankës së Shqipërisë, SHKOMAK-u do të jetë:
 - (a) për një bankë të përcaktuar si BARS sipas nenit 14, i njëjtë me: "KONS + SPEKUNC+ SIST+ ASTRUK";
 - (b) për një bankë që nuk është e përcaktuar si BARS, i njëjtë me: "KONS + SPEKUNC + ASTRUK".

Neni 7

Përbushja dhe raportimi i shtesës së kombinuar makroprudenciale të kapitalit (SHKOMAK)

- (1) Banka duhet të synojë përbushjen e vazhdueshme (në çdo kohë) të normës së SHKOMAK-ut (pra që $KNDr \geq SHKOMAK$ ose që $KNDr/SHKOMAK \geq 100\%$).
- (2) Për realizimin e kërkesës në paragrafin (1), banka angazhon burimet e nevojshme njerëzore, teknike dhe financiare, si edhe ndërton, dokumenton e rivlerëson rregullisht proceset e nevojshme të mbledhjes së të dhënave, llogaritjes, monitorimit, raportimit dhe vendimmarrjes.
- (3) Duke konsideruar më parë paragrafin (5), banka raporton në Bankën e Shqipërisë nivelin e përbushjes së SHKOMAK-ut, me frekuencë tremujore, mbi të dhënat e ditës së fundit të punës për muajt mars, qershor, shtator dhe dhjetor, sipas afateve të raportimit që zbaton Banka e Shqipërisë.
- (4) Për të përbushur kërkesën e paragrafit (3), banka përfshin në raportimin e periudhës të dhënat mbi:
 - (a) vlerën e llogaritur të SHKOMAK-ut, mbështetur në shumën e:
 - (i) vlerës së KONS-it, sipas nenit 10,
 - (ii) vlerës së llogaritur të SPEKUNC-it sipas nenit 11, për realizimin e së cilës më parë ka identifikuar:
 - juridiksionet ku ka EPSHK,
 - AKUNC-in për secilin juridiksion, sipas neneve 12 dhe 13,
 - (iii) normës së SIST-it, sipas nenit 14,
 - (iv) normës së ASTRUK-ut, sipas nenit 15;
 - (b) KMK për KBN1r, për KN1r dhe për RMK;

- (c) nivelet aktuale të KBN1r, të KN1r, të RMK;
 - (ç) kërkesat e tjera të detyrueshme të kapitalit, nëse zbatohen të tilla për bankën;
 - (d) vlerën e llogaritur të KNDr, duke zbritur nga vlera aktuale e KBN1, pjesën që nevojitet për plotësimin e KMK dhe të kërkesave të tjera të detyrueshme të kapitalit;
 - (dh) raportin e llogaritur të KNDr ndaj SHKOMAK-ut, në përqindje;
 - (e) përcaktimin e kuartilit të SHKOMAK-ut sipas nenit 8, tabela 1, dhe identifikimin e pozicionit të raportit të KNDr sipas nënparagrafit (dh), në kuartil;
 - (ë) vlerën maksimale të shpërndarjes.
- (5) Për herë të parë, raportimi sipas paragrafëve (3) dhe (4), do të jetë për ditën e fundit të punës të muajit mars 2020.
- (6) Për të përmbushur kërkesat për raportim sipas paragrafëve (4) dhe (5), banka përdor formën e raportimit në Aneksin 2.

Neni 8

Shtesa e kombinuar makroprudenciale e kapitalit (SHKOMAK) dhe pagesa e shpërndarjes

- (1) Banka, duke marrë në konsideratë paraprakisht paragrafin (3), mund të kryejë një pagesë shpërndarjeje, nëse:
- (a) e përmbush SHKOMAK-un;
 - (b) nuk e përmbush SHKOMAK-un, por gjeneron të ardhura pozitive.
- (2) Duke marrë në konsideratë paraprakisht paragrafin (4), banka nuk duhet të kryejë asnjë pagesë shpërndarjeje, në rastin kur:
- (a) nuk e përmbush SHKOMAK-un dhe nuk gjeneron të ardhura pozitive;
 - (b) ndonëse nuk gjendet në situatën e nënparagrafit (a):
 - (i) ende nuk ka realizuar veprimet e tjera të përcaktuara në nenin 9, paragrafët (1) dhe (2),
 - (ii) Banka e Shqipërisë e ka kundërshtuar kryerjen e pagesës sipas nenit 9, paragrafi (3).
- (3) Në rastin kur:
- (a) banka gjendet në kushtet e paragrafit (1)(a) të këtij neni dhe synon të kryejë një pagesë shpërndarjeje, atëherë pagesa mund të kryhet deri në vlerën që nuk cenon përmbushjen e SHKOMAK-ut;
 - (b) banka gjendet në kushtet e paragrafit (1)(b) të këtij neni dhe synon të kryejë një pagesë shpërndarjeje, atëherë, mbështetur në treguesit e tabelës 1, pagesa mund të kryhet vetëm:
 - (i) pasi banka ka përcaktuar kuartilin e SHKOMAK-ut, ku pozicionohet KNDr-ja; dhe
 - (ii) deri në masën e vlerës maksimale të shpërndarjes.

Tabela 1.

| Kuartili i SHKOMAK-ut ku pozicionohet KNDr | Përqindja maksimale e shpërndarjes |
|---|------------------------------------|
| Kuartili 1 (0%-25% e nivelit të SHKOMAK-ut) | 0% |
| Kuartili 2 (>25% - 50%) | 20% |
| Kuartili 3 (>50% - 75%) | 40% |
| Kuartili 4 (>75% - 100%) | 60% |

- (4) Kufizimet e parashikuara në paragrafët (2) dhe (3) zbatohen ndaj pagesave të shpërndarjes vetëm atëherë kur pezullimi ose ndalimi i asaj pagese nuk përfaqëson një ngjarje dështimi/falimentimi, shkakton nisjen e procedurave për caktimin e administratorit ose të likuidatorit të bankës, apo pengon veprimet e nevojshme në kuadër të ndërhyrjes së jashtëzakonshme në banka sipas ligjit nr. 133/2016. Banka njofton paraprakisht Bankën e Shqipërisë nëse vlerëson se ndodhet në secilën nga këto situata.

Neni 9

Veprimet e tjera të bankës në rastin e pagesës së shpërndarjes

- (1) Në rastin kur banka, për shkak të pagesës së shpërndarjes, konstaton se mund të shkaktojë mospërbushjen ose thellimin e mospërbushjes së SHKOMAK-ut, atëherë banka:
- (a) duhet të konsultojë Bankën e Shqipërisë, duke e njoftuar atë jo më pak se 15 ditë përpara se të kryejë pagesën e shpërndarjes;
 - (b) duhet të ofrojë çdo informacion që kërkohet nga Banka e Shqipërisë, duke përfshirë:
 - (i) vlerën e KBN1, të KN1, KREG dhe (eventualisht) të kërkesave të tjera të detyrueshme për kapital,
 - (ii) vlerën e fitimit për periudhat e ndërmjetme dhe për fundin e vitit,
 - (iii) vlerën maksimale të shpërndarjes, të llogaritur,
 - (iv) madhësinë dhe llojin e pagesës së shpërndarjes;
 - (c) duhet të paraqesë për miratim në Bankën e Shqipërisë, brenda një periudhe kohe të arsyeshme siç përcaktohet nga Banka e Shqipërisë, një plan që përmban masat që do të merren nga banka, sipas afateve kohore që mund të përcaktojë Banka e Shqipërisë, për përmirësimin e pozicionit të kapitalit të bankës dhe përmbushjen e SHKOMAK-ut.
- (2) Banka konsulton paraprakisht Bankën e Shqipërisë, edhe në rastin kur:
- (a) synon të gjenerojë kapitalin në treg, në mënyrë që të mundësojë kryerjen e pagesës së shpërndarjes, në një vlerë më të lartë se vlera maksimale e shpërndarjes që do të rezultonte nëse banka nuk do të rriste kapitalin;
 - (b) vlera e kapitalit që do të shtohet sipas nënparagrafit (a), nuk do të rezultojë në një përmirësim të dukshëm të pozicionit të kapitalit të bankës, pas kryerjes së pagesës së shpërndarjes;
 - (c) synon të kryejë pagesën e shpërndarjes, duke përfituar nga ulja e nivelit të SHKOMAK-ut në vijim të shpalljeve të Bankës së Shqipërisë.

- (3) Të gjitha veprimet që kryen banka dhe Banka e Shqipërisë, në situatat e parashikuara në paragrafët (1) dhe (2), nuk kufizojnë apo heqin të drejtën e Bankës së Shqipërisë:
- (a) për të refuzuar me shkrim kryerjen e pagesës së shpërndarjes nga banka, në tërësi ose për aq sa rrezikohet mospërbushja e SHKOMAK-ut;
- (b) për të refuzuar ose për të ndryshuar planin e paraqitur nga banka, dhe për të vendosur masa të tjera ndaj bankës, me qëllim përmirësimin e pozicionit të kapitalit të saj.

Neni 10 Shtesa konservuese e kapitalit (KONS)

- (1) Përveç rastit kur vepohet si në paragrafët (4) dhe (5), KONS-i dhe periudhat e përmbushjes së tij jepen në tabelën 2 dhe konsiderohen të vendosura sipas nenit 16, paragrafi (1), e të shpallura sipas nenit 17, paragrafi (1).

Tabela 2:

| | Viti 2020 (29 mars – 31 dhjetor) | Viti 2021 | Viti 2022 | Viti 2023 | Viti 2024 dhe në vazhdim |
|--------|----------------------------------|-----------|-----------|-----------|--------------------------|
| KONS = | 0.50% | 1.00% | 1.50% | 2.00% | 2.50% |

- (2) Banka përfshin nivelet e KONS-it sipas paragrafit (1), në përcaktimin e SHKOMAK-ut për periudhat përkatëse, sipas nenit 6.
- (3) Çdo vlerë e KBN1-së mbi vlerën minimale që kërkohet për plotësimin e KBN1r, konsiderohet e vlefshme për t'u përfshirë në KONS vetëm për pjesën që ka mbetur pas plotësimit më parë të kërkesës/-ave minimale për kapital për KN1r-në, për RMK-në dhe (eventualisht) për kërkesat e tjera të detyrueshme të kapitalit që zbatohen ndaj bankës.
- (4) Pavarësisht nga përcaktimet në paragrafin (1), Banka e Shqipërisë mund të shpallë një vlerë më të lartë të KONS-it në secilin nga vitet e periudhës 2020-2023, pa kapërcyer vlerën maksimale prej 2.5%, nëse kjo vlerësohet e nevojshme për shkak të rritjes së rreziqeve sistematike.
- (5) Në rastin kur vepohet sipas paragrafit (4):
- (a) vendimmarrja e Bankës së Shqipërisë për KONS-in realizohet sipas nenit 16, paragrafi (1) dhe shpallja e tij realizohet sipas nenit 17, paragrafi (1);
- (b) data efektive e KONS-it nuk mund të jetë më e afërt se 6 muaj dhe më e largët se 12 muaj, nga data e shpalljes.

Neni 11

Shtesa kundërciklike e kapitalit (KUNC), shtesa kundërciklike e kapitalit e aplikuar (AKUNC) dhe shtesa kundërciklike e kapitalit specifike për bankën (SPEKUNC)

- (1) KUNC-i:
- (a) për Shqipërinë, shpallet nga Banka e Shqipërisë, pasi është përcaktuar sipas nenit 12 dhe përdoret nga banka sipas këtij neni;
 - (b) për një juridiksion të huaj, banka përdor normën e shpallur nga autoriteti përgjegjës në juridiksionin e huaj, nëse Banka e Shqipërisë nuk ka shpallur një normë tjetër sipas nenit 13.
- (2) Në kushtet e përcaktuara në paragrafin (1)(a), Banka e Shqipërisë kujdeset që KUNC-i:
- (a) të vlerësohet dhe të përcaktohet me frekuencë tremujore;
 - (b) të ketë si rregull një vlerë midis 0% dhe 2.5%, përveç rastit kur analiza sipas nenit 12, paragrafi (2) justifikon një nivel më të lartë të normës; dhe
 - (c) të ndryshojë me një shumëfish të plotë të 0.25%.
- (3) Në kushtet e përcaktuara në paragrafin (1)(a), Banka e Shqipërisë kujdeset që KUNC-i të përcaktohet duke marrë në konsideratë:
- (a) treguesit e referencës sipas paragrafit (4);
 - (b) rekomandimet e nxjerra nga BERRS-i për përcaktimin e normës së shtesës kundërciklike të kapitalit; dhe
 - (c) faktorë të tjerë që Banka e Shqipërisë i konsideron të rëndësishëm për të trajtuar karakteristikat ciklike të rrezikut sistematik.
- (4) Banka e Shqipërisë kujdeset që treguesit e referencës sipas paragrafit (3)(a):
- (a) të reflektojnë, në një mënyrë sa më të drejtë, ciklin e kreditimit dhe rreziqet që shoqërojnë rritjen e tepërt të kreditimit në vend;
 - (b) të marrë në konsideratë në mënyrë të përshtatshme specifikat e ekonomisë së vendit;
 - (c) të mbështeten, pa u kufizuar, mbi shmangien e raportit të kredisë ndaj prodhimit të brendshëm bruto (PBB) prej prirjes së tij afatgjatë, duke marrë në konsideratë:
 - (i) një tregues të rritjes së nivelit të kreditimit brenda vendit, dhe veçanërisht, një tregues të ndryshimit të raportit të kredisë dhënë në vend ndaj PBB-së,
 - (ii) çdo orientim të dhënë për këtë qëllim nga BERRS-i.
- (5) Banka e Shqipërisë zhvillon një metodologji për përcaktimin e KUNC-it dhe e publikon atë. Në metodologji identifikohen treguesit e referencës që i shërbejnë gjykimit të saj për vlerësimin e ciklit financiar, mbështetur në ecurinë e kreditimit, mënyrën se si ata ndërlidhen me nivelin e KUNC-it, si edhe në procesin që ndjek Banka e Shqipërisë për vlerësimin e

rreziqeve që lidhen me kreditimin e shpejtë.

(6) Mbi bazën e KUNC-it të përcaktuar sipas paragrafit (1), banka llogarit:

(a) SPEKUNC-in, sipas formulës:

$$\text{SPEKUNC} = (\sum (\text{KPK_EPSHK}_j * \text{AKUNC}_j)) / \sum \text{KPK_EPSHK}_j$$

ku:

j – është Shqipëria dhe çdo juridiksion i huaj ku banka ka EPSHK dhe që zbaton shtesën kundërciklike të kapitalit (duke përfshirë edhe normën 0%),

KPK_EPSHK_j – është shuma e:

- kërkesës për kapital rrjedhur nga EPSHK-të e bankës sipas nenit 4, nënparagrafit (30) (a), në juridiksionin j , dhe
- kërkesës për kapital rrjedhur nga EPSHK-të e bankës, sipas nenit 4, nënparagrafit (30)(b), në juridiksionin j , dhe
- kërkesës për kapital rrjedhur nga EPSHK-të e bankës, sipas nenit 4, nënparagrafit (30)(c), në juridiksionin j ,

AKUNC_j – është KUNC-i i aplikuar në juridiksionin j (Shqipëri ose një vend i huaj) ose çdo shtesë kapitali që ka qëllimin e KUNC për juridiksion j , i përcaktuar sipas nenit 12 dhe nenit 13;

(b) vlerën absolute të shtesës kundërciklike të kapitalit, e cila është e barabartë me prodhimin e SPEKUNC-it me EPR-në (SPEKUNC * EPR).

(7) Nëse vlera e llogarit e SPEKUNC-it sipas paragrafit (6)(a) kapërcen vlerën në tabelën 3 sipas periudhës së përmbushjes, atëherë banka mund të zgjedhë të përdorë si normë të SPEKUNC-it vlerën përkatëse në tabelën 3:

Tabela 3:

| | Viti 2020 (29 mars – 31 dhjetor) | Viti 2021 | Viti 2022 | Viti 2023 | Viti 2024 dhe në vazhdim |
|-----------|-------------------------------------|-----------|-----------|-----------|-----------------------------|
| SPEKUNC ≤ | 0.625% | 1.25% | 1.875% | 2.50% | 3.00% |

(8) Niveli i SPEKUNC-it, përfshihet në llogaritjen e SHKOMAK-ut për periudhat përkatëse, sipas nenit 6.

(9) Banka ka përgjegjësinë:

- (a) të përcaktojë dhe të raportojë të gjitha juridiksionet ku ka EPSHK sipas paragrafit 10, si edhe llojet e EPSHK-ve;
- (b) të identifikojë normën e AKUNC-it dhe ndryshimet e saj, në juridiksionet ku ka ose synon të krijojë EPSHK;
- (c) pa shmangur përgjegjësinë e saj për plotësimin e kërkesës së nënparagrafit (b), mund të konsultojë paraprakisht Bankën e Shqipërisë, nëse ka vështirësi në identifikimin e AKUNC-it.

(10) Për të përmbushur kërkesën e paragrafit (9)(a), banka e identifikon juridiksionin përkatës sipas konceptit të lokalizimit të rrezikut përfundimtar,

në përputhje me nenin 4, paragrafi (1), nënparagrafët (31), (32) dhe (33).

- (11) Për identifikimin e EPSHK-ve dhe llogaritjen e SPEKUNC-it, banka raporton sipas formularit në Aneksin 3, me përjashtim të rastit kur vepron sipas nenit 13, paragrafi (6)(c).

Neni 12

Shtesa kundërcikike e kapitalit e aplikuar (AKUNC) në rastin e Shqipërisë dhe data efektive e zbatimit

- (1) Për rastin kur bankat kanë EPSHK në Shqipëri dhe kur plotësohet parashikimi në nenin 13, paragrafi (6), AKUNC-i është i njëjtë me KUNC-in e shpallur nga Banka e Shqipërisë, sipas këtij neni.
- (2) Pavarësisht përcaktimeve në nenin 11, paragrafi (2), Banka e Shqipërisë mund të shpallë një KUNC më të lartë se 2.5%, nëse njëherazi:
- (a) niveli më i fundit i KUNC-it është 2.5% dhe ka qenë në zbatim për një periudhë kohe jo më të shkurtër se 6 muaj;
 - (b) vlerëson se ritmi i rritjes së kredisë nuk është ngadalësuar mjaftueshëm gjatë periudhës;
 - (c) vlerëson se kjo është e nevojshme për të mbrojtur bankat nga pasojat e mundshme të padëshiruara të rritjes së shpejtë të kreditit dhe rritjes së rreziqeve për gjithë sistemin financiar në vend.
- (3) Banka e Shqipërisë e shpall normën e KUNC-it për herë të parë deri në muajin qershor të vitit 2019 dhe më tej vijon ta kryejë këtë veprim çdo tre muaj.
- (4) Banka e Shqipërisë përcakton datën efektive të KUNC-it, duke u kujdesur që:
- (a) në rastin kur shpall normën e KUNC-it për herë të parë, data efektive e KUNC-it të jetë jo më e afërt se data 29 mars 2020;
 - (b) duke konsideruar më parë pikën (a), kur vendos për rritjen e KUNC-it, data efektive të jetë jo më afër se 6 muaj dhe jo më larg se 12 muaj nga data e shpalljes;
 - (c) në rastin kur vendos për uljen e KUNC-it sipas paragrafit (5), të veprojnë sipas paragrafit (6).
- (5) Nëse Banka e Shqipërisë vlerëson se rreziqet për të gjithë sistemin financiar, të lidhura me kreditimin e shpejtë, po zvogëlohen ose që sistemi financiar po hyn në një gjendje ngërçi në zhvillimin e veprimtarisë së ndërmjetësimit financiar, ajo mund të shpallë uljen e normës së KUNC-it.
- (6) Në rastin e uljes së KUNC-it sipas paragrafit (5), Banka e Shqipërisë shpall edhe:

- (a) datën efektive e cila, nëse nuk është e njëjtë me datën e shpalljes, nuk duhet të jetë më e largët prej saj se 6 muaj;
- (b) periudhën e kohës gjatë së cilës ajo nuk pret një rritje të KUNC-it.

Neni 13

Shtesa kundërciklike e kapitalit e aplikuar (AKUNC) në rastin e juridiksionit të huaj dhe data efektive e zbatimit

- (1) Për rastin kur bankat kanë EPSHK në një juridiksion të huaj, dhe duke marrë në konsideratë paraprakisht paragrafin (6), AKUNC-i për juridiksionin e huaj përcaktohet sipas këtij neni.
- (2) Duke marrë në konsideratë paraprakisht paragrafin (6):
 - (a) në rastin kur për një juridiksion të huaj nuk ka pasur një shpallje të KUNC-it nga autoriteti përkatës i atij juridiksioni, atëherë:
 - (i) nëse ka një shpallje nga ana e Bankës së Shqipërisë sipas paragrafit (3), AKUNC-i është ai që është shpallur nga Banka e Shqipërisë,
 - (ii) nëse nuk plotësohet kushti në nënparagrafin (a)(i), AKUNC-i për juridiksionin e huaj është 0%;
 - (b) në rastin kur KUNC-i i shpallur nga autoriteti përgjegjës në një juridiksion të huaj është deri në 2.5%, atëherë:
 - (i) nëse ka një shpallje nga ana e Bankës së Shqipërisë sipas paragrafit (3), AKUNC-i është ai i shpallur nga Banka e Shqipërisë,
 - (ii) nëse nuk plotësohet kushti në nënparagrafin (b)(i), AKUNC-i për juridiksionin është i njëjtë me KUNC-in e shpallur në atë juridiksion;
 - (c) në rastin kur KUNC-i i shpallur në një juridiksion të huaj është më i madh se 2.5%, atëherë:
 - (i) nëse ka një shpallje nga ana e Bankës së Shqipërisë sipas paragrafit (3), AKUNC-i është ai i shpallur nga Banka e Shqipërisë,
 - (ii) nëse nuk plotësohet kushti në nënparagrafin (c)(i), AKUNC-i për juridiksionin e huaj është i barabartë me 2.5%.
- (3) Nëse Banka e Shqipërisë vlerëson se KUNC-i për një juridiksion të huaj sipas paragrafit (2), nënparagrafëve (a)(ii), (b)(ii) ose (c)(ii), nuk është i mjaftueshëm për të përmirësuar rezistencën e bankës ndaj rreziqeve me të cilat përballet për shkak të rritjes së tepërt të kredisë në atë juridiksion, Banka e Shqipërisë mund të shpallë si AKUNC vlerat më poshtë:
 - (a) për rastin e parashikuar në paragrafin (2), (a) ose (b), një vlerë më të lartë se KUNC-i i juridiksionit të huaj, por jo më të lartë se 2.5%;
 - (b) për rastin e parashikuar në paragrafin (2)(c), një vlerë të njëjtë me KUNC-in e juridiksionit të huaj.
- (4) Duke marrë në konsideratë paraprakisht paragrafin (6)(c), data efektive e

AKUNC-it për juridiksionin e huaj do të jetë data efektive e KUNC-it siç është shpallur nga autoriteti përgjegjës i atij juridiksioni.

(5) Pavarësisht nga përcaktimet në paragrafin (4), data efektive e AKUNC-it për juridiksionin e huaj:

- (a) do të konsiderohet data 29 mars 2020, nëse është më e afërt se kjo datë;
- (b) në rastin e rritjes së KUNC-it dhe duke marrë në konsideratë paraprakisht pikën (a): nuk mund të jetë më afër se 6 muaj ose më larg se 12 muaj nga data e shpalljes;
- (c) në rastin e uljes së KUNC-it dhe duke marrë në konsideratë paraprakisht pikën (a): nëse nuk është e njëjtë me datën e shpalljes, nuk mund të jetë më larg se 6 muaj prej saj.

(6) Nëse:

(a) në raport me totalin e EPSHK-ve të bankës:

- (i) shuma e EPSHK-ve e lokalizuar në juridiksione të huaja, nuk e kalon nivelin 2%, dhe/ose
- (ii) shuma e EPSHK-ve të formës së përcaktuar në nenin 4, paragrafi (1) (29)(a)(iii), nuk e kalon nivelin 2%;

dhe/ose:

(b) pavarësisht përpjekjeve të posaçme të bankës, mbështetur në informacionin e disponueshëm, është e pamundur të përcaktohet subjekti që mban rrezikun përfundimtar tek një EPSHK që është në një juridiksion të huaj;

atëherë banka:

(c) mund ta konsiderojë vlerën e EPSHK-ve sipas nënparagrafëve (a) dhe (b) si të lokalizuar në juridiksionin e bankës (në Shqipëri) dhe vepron sipas nenit 12 për të identifikuar AKUNC-in dhe sipas nenit 11 për të llogaritur SPEKUNC-in; dhe

(ç) raporton sipas formularit në Aneksin 4;

(d) nëse ekspozimet për juridiksionin e bankës përfshijnë edhe ekspozime sipas nënparagrafëve (a) dhe (b), banka i evidenton këto me një shënim të posaçëm në formën e raportimit sipas nënparagrafit (ç).

Neni 14

Shtesa e kapitalit për bankat me rëndësi sistemike (SIST) dhe data efektive e zbatimit

(1) Një bankë do të vlerësohet si BARS nëse, në vlerësimin e Bankës së Shqipërisë, treguesit e madhësisë, ndërlidhjes, shkallës së zëvendësueshmërisë, kompleksitetit të veprimtarisë së bankës dhe tregues

të tjerë të veprimtarisë së saj, janë të tillë që e bëjnë bankën të ketë një ndikim të rëndësishëm në funksionimin efektiv dhe qëndrueshmërinë e sektorit bankar dhe të sistemit financiar në Shqipëri, në rastin kur banka do të përballej me një situatë paqëndrueshmërie financiare.

- (2) Banka e Shqipërisë zhvillon një metodologji të posaçme për përcaktimin e një banke si BARS dhe mënyrën e aplikimit të SIST-it, dhe e publikon atë. Si rregull, metodologjia rishikohet të paktën një herë në 5 vjet.
- (3) Në metodologji, Banka e Shqipërisë, mes të tjerash, përcakton:
 - (a) peshat e treguesve të paragrafit (1), nëntreguesit përbërës të tyre dhe peshat e këtyre nëntreguesve;
 - (b) të paktën pesë shporta të rëndësishme sistemike, ku shporta e fundit nuk ka kufi të sipërm (shportë e hapur);
 - (c) që kalimi nga shporta e parë drejt shportave të tjera tregon rritjen e kontributit të bankës në rrezikun sistemik dhe sugjeron rritjen lineare të SIST-it, me përjashtim të shportës së hapur;
 - (ç) gjerësinë në pikë të çdo shporte, me përjashtim të shportës së hapur, dhe kufijtë në pikë që ndajnë shportat e njëpasnjëshme;
 - (d) notën e rëndësishme sistemike për bankën e vlerësuar si BARS, e cila më tej mundëson pozicionimin e saj në shportën përkatëse të rëndësishme sistemike;
 - (dh) nivelin e SIST-it për shportën e parë, madhësinë e rritjes së SIST-it nga shporta e parë deri në shportën e hapur (pa e përfshirë), dhe vlerën e SIST-it për shportën e hapur.
- (4) Nëse Banka e Shqipërisë nuk e përcakton ndryshe:
 - (a) shporta e parë e rëndësishme sistemike do të ketë si SIST vlerën 0.5%;
 - (b) madhësia e rritjes lineare të SIST-it nga shporta e parë deri në shportën e hapur (pa e përfshirë) do të jetë 0.5%;
 - (c) vlera e SIST për shportën e hapur do të jetë 3%.
- (5) Për zbatimin e SIST-it, Banka e Shqipërisë:
 - (a) duke marrë në konsideratë paraprakisht paragrafin (ó), përcakton një herë në vit, brenda tremujorit të parë, listën e BARS dhe SIST-et përkatëse, duke u mbështetur në të dhënat e muajit dhjetor të vitit paraardhës;
 - (b) përcakton datën efektive të zbatimit të SIST-it, e cila duhet të jetë:
 - (i) në rastin e rritjes së SIST-it (për shkak të rritjes së notës së rëndësishme sistemike të bankës së përcaktuar si BARS dhe të kalimit të saj në një shportë më të lartë të rëndësishme sistemike), si rregull, 1 janari i vitit pasardhës, por në çdo rast jo më e largët se 12 muaj nga data e shpalljes,
 - (ii) në rastin e uljes së SIST-it, në ditën e parë të punës që pason datën e shpalljes.
- (ó) Për herë të parë, sipas kësaj rregulloreje, BARS do të përcaktohen deri në muajin qershor të vitit 2019.

- (7) Për bankën e përcaktuar si BARS sipas paragrafit (6), norma e SIST-it që duhet të përmbushet nga banka, në varësi të shportës së rëndësisë sistemike ku ajo pozicionohet, do të jetë sipas vlerave në tabelën 4:

Tabela 4:

| | Viti 2020 (29 mars – 31 dhjetor) | Viti 2021 | Viti 2022 | Viti 2023 | Viti 2024 dhe në vazhdim |
|--------|----------------------------------|---------------------|-----------------------------|-----------------------------------|---|
| SIST = | 0.5% | Një nga: {0.5%; 1%} | Një nga: {0.5%; 1.0%; 1.5%} | Një nga: {0.5%; 1.0%; 1.5%; 2.0%} | Një nga: {0.5%; 1.0%; 1.5%; 2.0%; 3.0%} |

- (8) SIST-i i përcaktuar sipas paragrafit (7), përfshihet në përcaktimin e SHKOMAK-ut për periudhën përkatëse, sipas nenit 6.
- (9) Në vijim të procesit të përcaktuar në paragrafët (1) deri në (7), Banka e Shqipërisë shpall listën e bankave të përcaktuara si BARS, së bashku me normën e SIST-it që ato duhet të përmbushin sipas shportës së rëndësisë sistemike ku pozicionohen për shkak të notës përkatëse të rëndësisë sistemike.

Neni 15

Shtesa e kapitalit për rrezikun sistematik (STRUK), shtesa e kapitalit për rrezikun sistematik e aplikuar (ASTRUK) dhe data efektive e zbatimit

- (1) Kur vlerëson se sektori bankar dhe sistemi financiar ndeshen me zhvillime apo dukuri të natyrës strukturore, jociklike, të cilat mund të rrezikojnë qëndrueshmërinë e të gjithë sistemit financiar ose të një segmenti të caktuar të tij, Banka e Shqipërisë, duke marrë në konsideratë paragrafët (2) dhe (3), mund të zbatojë STRUK-un.
- (2) STRUK-u mund të zbatohet për të gjitha ose për një pjesë të bankave, duke shqyrtuar të gjitha ekspozimet e bankës ose një pjesë të tyre, pa kufizime përsa i takon juridiksionit të ekspozimeve dhe në nivele të njëjta ose të ndryshme për bankat. Për bankat e përcaktuara si BARS, STRUK-u zbatohet pasi Banka e Shqipërisë vlerëson që rreziku strukturor nuk adresohet mjaftueshëm nëpërmjet SIST-it.
- (3) Midis bankave:
- (a) për ato që janë të përcaktuara si BARS, ASTRUK-u mund të jetë i barabartë ose më i vogël se STRUK-u, në kushtet kur zbatimi i përbashkët i SIST-it dhe ASTRUK-ut, të mbledhur me njëri-tjetrin, nuk duhet të kapërcejë vlerën 4%;
- (b) për ato që NUK janë të përcaktuara si BARS, ASTRUK-u është i barabartë me STRUK-un.
- (4) Kur Banka e Shqipërisë e shpall ose e ndryshon më pas nivelin e STRUK-ut, atëherë ajo kujdeset që të plotësohen kriteret e mëposhtme:
- (a) të publikojë arsyet e vendosjes së STRUK-ut dhe pritshmëritë e saj për

- mënyrën se si kjo shtesë makroprudenciale e kapitalit do të adresojë rreziqet sipas paragrafëve (1) dhe (2);
- (b) niveli minimal i STRUK-ut të jetë 1%;
 - (c) mbi nivelin minimal, STRUK-u të ndryshojë me shumëfisha të plotë të vlerës 0.5%;
 - (ç) niveli maksimal i STRUK-ut të jetë 3%.
- (5) Duke marrë në konsideratë paraprakisht kufizimet sipas paragrafit (3)(a) dhe në varësi të kohës së shpalljes së STRUK-ut nga Banka e Shqipërisë sipas paragrafit (6), norma e ASTRUK-ut që duhet të përmbushet nga banka do të jetë sipas vlerave në tabelën 5:

Tabela 5:

| | Viti 2020 (29 mars – 31 dhjetor) | Viti 2021 | Viti 2022 | Viti 2023 | Viti 2024 dhe në vazhdim |
|----------|-------------------------------------|--------------------------|--------------------------------|--------------------------------------|--|
| ASTRUK = | 1.0% | Një nga: {1.0%; 1.5%} | Një nga: {1.0%; 1.5%; 2.0%} | Një nga: {1.0%; 1.5%; 2.0%; 2.5%} | Një nga: {1.0%; 1.5%; 2.0%; 2.5%; 3%} |

- (6) Duke marrë në konsideratë paraprakisht paragrafin (7):
- (a) Banka e Shqipërisë mund të shpallë për herë të parë nivelin e STRUK-ut pas muajit qershor të vitit 2019;
 - (b) pas shpalljes për herë të parë të STRUK-ut sipas pikës (a), Banka e Shqipërisë kujdeset që:
 - (i) rivlerësimi dhe shpalljet vijuese të STRUK-ut të kryhen të paktën një herë në 2 vjet,
 - (ii) procesi i rivlerësimit dhe i shpalljes së STRUK-ut të përqendrohet gradualisht në tremujorin e parë të vitit.
- (7) Në rastin kur e gjykon të nevojshme t’iu përgjigjet ndryshimeve të shpejta në drejtim të zhvillimit të rreziqeve strukturore në sektorin bankar dhe sistemin financiar, Banka e Shqipërisë vepron pa u kufizuar nga përcaktimet në paragrafët (5) dhe (6).
- (8) Banka e Shqipërisë përcakton datën efektive të STRUK-ut, e cila:
- (a) në rastin e vendosjes për herë të parë ose të rritjes së STRUK-ut duhet të jetë, si rregull, duke filluar nga data 1 janar e vitit pasardhës, por në çdo rast jo më vonë se 12 muaj nga data e shpalljes;
 - (b) në rastin e uljes së STRUK-ut duhet të jetë, si rregull, menjëherë, por në çdo rast jo më vonë se 6 muaj nga data e shpalljes.
- (9) Niveli i ASTRUK-ut, sipas STRUK-ut të shpallur nga Banka e Shqipërisë, përfshihet në përcaktimin e SHKOMAK-ut për periudhat përkatëse, sipas nenit 6.

Neni 16 Vendimmarrja

(1) Vendimmarrja e Bankës së Shqipërisë për përcaktimin e SHMAK-ut:

- (a) sipas nenit 2;
- (b) sipas nenit 5, paragrafi (1);
- (c) sipas nenit 10, paragrafi (4);
- (ç) sipas neneve 11, 12 dhe 13;
- (d) sipas nenit 14, paragrafëve (5) dhe (6); dhe
- (dh) sipas nenit 15;

nëkuqton, vendimin e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë mbi llojin, vlerën, listën e bankave që i nënshtrohen, datën efektive dhe elemente të tjera të rëndësishëm për zbatimin e SHMAK-ut.

(2) Duke marrë në konsideratë paraprakisht paragrafin (1), të gjitha veprimet e tjera që kryen Banka e Shqipërisë në drejtim të:

- (a) komunikimit me autoritetet përgjegjëse të juridiksioneve të huaja sipas nenit 2, paragrafi (b) dhe sipas nenit 5, paragrafi (3);
- (b) miratimeve, refuzimeve apo rishikimeve sipas nenit 8, paragrafi (2)(b)(ii) dhe sipas nenit 9, paragrafi (1)(c) dhe paragrafi (3);
- (c) publikimit të metodologjive sipas nenit 11, paragrafi (5) dhe nenit 14, paragrafi (2);
- (ç) komunikimit sipas nenit 17, paragrafi (2);
- (d) proceseve që ndihmojnë veprimet e përcaktuara në nën paragrafët (a) deri në (ç);

autorizohen nga Zëvendësguvernatori i Dytë i Bankës së Shqipërisë.

Neni 17 Shpallja dhe komunikimi për shtesën makroprudenciale të kapitalit (SHMAK) nga Banka e Shqipërisë

(1) Shpallja e SHMAK-ut nga ana e Bankës së Shqipërisë, ka kuptimin e publikimit të vendimit të nenit 16, paragrafi (1), dhe të informacionit shoqërues përkatës, si më poshtë:

- (a) me shkrim, dërguar bankave mbi të cilat zbatohet SHMAK-u; dhe
- (b) përmes vendosjes në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë.

(2) Përveç sa përcaktohet në këtë rregullore, kur e gjykon të nevojshme për të rritur efektivitetin e shtesave makroprudenciale të kapitalit, Banka e Shqipërisë ndërmer edhe veprime të tjera për të komunikuar rreth tyre me palët e interesuara, brenda dhe jashtë vendit. Komunikimi me palët e interesuara do të synojë shpjegimin e nevojës për shtesat makroprudenciale të kapitalit, konsultimin rreth tyre në momentin e

vendosjes apo të ndryshimit dhe koordinimin e përgatitjeve për zbatimin e tyre.

Neni 18 **Konsultimi nga banka**

(1) Kërkesat, njoftimet apo konsultimet që banka kryen me Bankën e Shqipërisë:

- (a) sipas nenit 5, paragrafi (1);
- (b) sipas nenit 8, paragrafi (4);
- (c) sipas nenit 9, paragrafët (1) dhe (2);
- (ç) sipas nenit 11, paragrafi (9)(c); dhe
- (d) të tjera, për qëllimin e zbatimit të kësaj rregulloreje;

paraqiten zyrtarisht, me shkrim.

(3) Në rast nevoje, banka mund të përdorë postën elektronike për komunikimin sipas paragrafit (1), por kjo nuk zëvendëson konfirmimin zyrtar, me shkrim, të përmbajtjes së komunikimit, i cili duhet të dërgohet në Bankën e Shqipërisë sa më shpejt të jetë e mundur.

(4) Komunikimi zyrtar me shkrim sipas paragrafit (1), i adresohet Zyrës së Zëvendësguvernatorit të Dytë të Bankës së Shqipërisë. Komunikimi nëpërmjet postës elektronike sipas paragrafit (2), dërgohet në adresën SHMAK@bankofalbania.org.

Neni 19 **Masat korrektuese**

Banka e Shqipërisë, mund të verifikojë në çdo kohë mënyrën e zbatimit të kërkesave të kësaj rregulloreje nga banka. Në këtë rast, banka ofron të gjithë informacionin e kërkuar, në formën dhe afatet e përcaktuara nga Banka e Shqipërisë. Në rast të mosplotësimit të kërkesave të kësaj rregulloreje nga banka dhe të kërkesave për informacion në kuadër të verifikimit të zbatimit të saj, Banka e Shqipërisë zbaton masat mbikëqyrëse dhe/ose ndëshkimore të parashikuara në Kreun VI të ligjit nr. 9662/2006, i ndryshuar.

Neni 20 **Dispozita përfundimtare**

Aneksat 1, 2, 3 dhe 4, i bashkëlidhen rregullores dhe janë pjesë përbërëse e saj. Aneksi 5 (Shembull) i bashkëlidhet rregullores, por ka vetëm qëllim ilustrimi.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS

GENT SEJKO

ANEKS 1: VENDOSJA GJEOGRAFIKE E SHITESËS KUNDËRCIKLIKE TË KAPITALIT (KUNC)

| | | Në bankën vendase | Në filialet e huaja | Në degët e huaja |
|-------|---|---------------------------------|---------------------------------|---------------------------------|
| I | Për ekspozimet në juridiksionin vendas | Po | NA | NA |
| II | Për ekspozimet ndërkufitare (të huaja), kur autoriteti mbikëqyrës pritës ka shpallur një normë të KUNC | | | |
| (i) | Ekspozim nëpërmjet filialeve | Jo | Po | NA |
| (ii) | Ekspozim nëpërmjet degëve | | | |
| (a) | Ku rregulloret e juridiksionit pritës nuk kërkojnë që kapitali rregullator të mbahet pranë degëve | Po | NA | Jo |
| (b) | Ku rregulloret e juridiksionit pritës kërkojnë që kapitali rregullator të mbahet pranë degëve | Jo | NA | Po |
| (iii) | Ekspozim direkt nga banka vendase | Po | NA | NA |
| III | Për ekspozimet ndërkufitare, ku autoriteti mbikëqyrës pritës nuk ka shpallur një normë të KUNC-it, por autoriteti i vendit të origjinës beson se duhet të zbatohet; ose ku autoriteti mbikëqyrës pritës ka shpallur një normë të KUNC-it, por autoriteti i vendit të origjinës beson se ajo duhet të jetë në një nivel më të lartë (nevojitet një shtesë në normën e KUNC-it) | | | |
| (i) | Ekspozim nëpërmjet filialeve | Po, por në diskrecion të bankës | Po, por në diskrecion të bankës | NA |
| (ii) | Ekspozim nëpërmjet degëve | | | |
| (a) | Ku rregulloret e juridiksionit pritës nuk kërkojnë që kapitali rregullator të mbahet pranë degëve | Po | NA | Jo |
| (b) | Ku rregulloret e juridiksionit pritës kërkojnë që kapitali rregullator të mbahet pranë degëve | Po, por në diskrecion të bankës | NA | Po, por në diskrecion të bankës |
| (iii) | Ekspozim direkt nga banka vendase | Po | NA | NA |

NA - Nuk aplikohet

ANEKS 2: RAPORTIMI PËR PËRMBUSHJEN E SHKOMAK

| | |
|------------------------|-----------|
| Banka | YYY |
| BARS? | Po |
| Shporta | IV |
| Periudha e raportimit: | 3/29/2020 |

Vlerat në kutitë me ngjyrë, vendosen nga banka!

Tabela 1: Raportimi i bankës për mënyrën e përmbushjes

| | Elementet | Vlera |
|--------------------------|--|---------------|
| (1) | Kapitali Bazë i nivelit të parë - KBN1 (mln lekë) | 10,000,000.00 |
| (2) | Kapitali i nivelit të parë - KN1 (mln lekë) | 12,045,454.55 |
| (3) | Kapitali rregullator - KREG (mln lekë) | 14,772,727.27 |
| (4) | Ekspozimet e peshuara me rrezik - EPR (mln lekë) | 90,909,090.91 |
| | Raportet e kapitalit, në % | |
| (5)=(1)/(4) | Raporti i kapitalit bazë të nivelit të parë - KBN1r: | 11.00% |
| (6)=(2)/(4) | Raporti i kapitalit të nivelit të parë - KN1r* | 13.25% |
| (7)=(6)-(5) | - nga i cili, Kapitali shtesë i nivelit të parë (KSHN1r) | 2.25% |
| (8)=(3)/(4) | Kapitali rregullator + Shtylla II (RMK)** | 16.25% |
| (9)=(8)-(6) | - nga i cili, Kapitali i nivelit të dytë (KN2r) | 3.00% |
| (10) | - nga i cili, Shtylla II | 0.00% |
| (10.1) | - nga i cili, kërkesa të ligjit nr. 133/2016 | |
| | Kërkesat minimale të Bankës së Shqipërisë | |
| (11) | Raporti i kapitalit bazë të nivelit të parë (KBN1): | 6.75% |
| (12) | Raporti i kapitalit të nivelit të parë (KN1) | 9% |
| (13) | Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (RMK) | 12% |
| | Përmbushja e SHKOMAK | |
| (14) | Niveli i KNDr (merret nga Tabela X.1 - vlera (d)(5)) | 4.25% |
| (15) | Niveli i KONS (i përcaktuar nga BSh) | 0.625% |
| (16) | Niveli i SPEKUNC (i llogaritur nga banka) | 1.50% |
| (17) | Niveli i SIST (i përcaktuar nga BSh) | 1.00% |
| (18) | Niveli i ASTRUK (i përcaktuar nga BSh) | 2.00% |
| (19)=(15)+(16)+(17)+(18) | Niveli i SHKOMAK | 5.125% |
| (20)=(14)/(19) | Përmbushja e SHKOMAK | 82.9% |

Shënim: Të gjitha vlerat në tabelë, janë të supozuara me qëllim instruktimitin e plotësimit të saj.

Tabela 1.1: Llogaritja e raportit të Kapitalit të Disponueshëm Neto (KNDR)

| | Kapitali bazë i nivelit të parë (KBN1) | Kapitali i nivelit të parë (KN1) | Kapitali rregullator (KREG) | |
|-----|--|--|---|--|
| | | | (c) | (b) |
| (1) | Kërkesat minimale të kapitalit (+ Shylla II, ligji 133/2016) | 6.75% | 9.00% | 12.00% |
| (2) | Ç'pjesë të kapitalit, mbi KBN1r, mund të plotësojë banka me KBN1? | Tab.X: Vlera (12)/Vlera (11) 2.25% | Tab.X: Vlera (13)/Vlera (12) 3.00% | |
| (3) | Ç'pjesë e kapitalit, mbi KBN1r, është plotësuar me instrumente të ndryshme nga KBN1? | Tab.X: Vlera (7) 2.25% | Tab.X: Vlera (9) 3.00% | |
| (4) | Sa është nevoja për KBN1, që të plotësohen KSHN1r dhe KN2r? | Kjo Tab: (b)/(2) 0.00% | Kjo Tab: (c)/(3) - (c)/(2) 0.00% | |
| (5) | Sa është teprica e KBN1r, që mund të përdoret për përbushjen e SHKOMAK (KNDR)? | Tab X: Vlera (55) - Kjo Tab:(a)/(1) 4.25% | Kjo Tab: (b)/(4) 0.00% | Kjo Tab: (c)/(4) 0.00% |
| | | Çdo tepricë e KBN1 këtu (g36>0) mund të përdoret për plotësimin e SHMAK nëse nuk nevojitet për të përbushur kërkesat për KN1 (KSHN1r), KREG (KN2r) dhe Shyllën II. | Çdo mungesë në KN1 këtu (h34<0), duhet të plotësohet duke përdorur KBN1 që nuk nevojitet për të plotësuar kërkesën minimale të KBN1. Çdo tepricë e KN1 këtu (h34>= 0), mund të përdoret për të plotësuar kërkesën për KREG dhe do të pakësojë ose largojë nevojën e përdorimit të KBN1 për këtë qëllim. | Çdo mungesë në KREG këtu (I347<0) mund të plotësohet duke përdorur KN1 e tepërt që nuk është KBN1, nëse ekziston. Nëse kjo nuk është e mjaftueshme, atëherë mungesa duhet të plotësohet duke përdorur KBN1, i cili nuk nevojitet për të plotësuar KBN1 dhe të kërkesat minimale të KBN1 dhe të KN1 |
| | | | | KNDR: Kjo Tab: $\text{Max}(0, (a) - (5) + (b) / (5) + (c) / (5))$ 4.25% |
| | | | | KNDR është kapitali i disponueshëm neto KNB1 që nuk nevojitet për të plotësuar kërkesën për KBN1 dhe çdo deficit në KN1, KREG dhe Shyllën II. |

TABELA 2. Informacion plotësues për identifikimin e normave të AKUNC

| | |
|-------------------------------|-------------|
| Banka: | YYY |
| Niveli i zbatimit: | Individuale |
| Periudha e raportimit: | 3/31/2020 |

| Juridiksioni | Norma e AKUNC | Shpallur nga: | Data e shpalljes | Data e zbatimit | Adresa elektronike | Të tjera |
|-----------------------------------|---------------|--------------------|------------------|-----------------|-----------------------|----------|
| Shqipëri | 1.00% | Banka e Shqipërisë | 2/15/2019 | 2/15/2020 | www.bankofalbania.org | |
| B | 0.50% | Autoriteti B* | | | ... | |
| C | 1.00% | Autoriteti C* | | | ... | |
| D | 2.00% | Autoriteti D* | | | ... | |
| ... (lista zgjatet sipas nevojës) | ... | | | | | |

Shënim: Mund të jetë edhe Banka e Shqipërisë, nëse ajo ka shpallur një normë të AKUNC për juridiksionin e huaj, sipas nenit 12 të rregullores "Për shtesat makroprudenciale të kapitalit"

TABELA 3. Vlera e SPEKUNC (duke iu referuar Tab. 1)

| | |
|-------------------------------|-------------|
| Banka: | YYY |
| Niveli i zbatimit: | Individuale |
| Periudha e raportimit: | 3/31/2020 |

| Elementi | Vlera |
|--|------------|
| Totali i ekspozimeve të peshuara me rrezik (EPR) - mln lekë | 850,000.00 |
| SPEKUNC (%) | 0.97% |
| Vlera absolute e Shtesës Kundërciklike të Kapitalit - mln lekë | 8,268.74 |

Shënim: Të gjitha vlerat në tabela, janë të supozuara me qëllim instruktivim e plotësimit të tyre.

ANEKS 4. LLOGARITJA DHE RAPORTIMI I SPEKUNC, KUR BANKA E KA TË MUNDUR DHE ZGJEDH T'I LOKALIZOJE EPSHK-TË NË JURIDIKSIONIN E VET

TABELA 1.1 (OPSIONALE)

| | |
|------------------------|-------------|
| Banka: | YYY |
| Niveli i zbatimit: | Individuele |
| Periodha e raportimit: | 3/31 /2020 |

| Juridiksioni | Ekspozimet e përshtatura të kreditit - EPSHK (min lekë) | | Të tregut | | Totali | | Kërkesa për kapital (min lekë) | | | Pesha në Kërkesën për Kapital (%) | Norma e zbatuar e shesës kundërciklike të kapitalit- AKUNC (%) |
|------------------------------------|---|-------------------|------------------|-------------------|-------------------------------|----------------------------|--------------------------------|------------------|----------------|-----------------------------------|--|
| | Jo të titulluara | Të titulluara | Të tregut | Totali | Për EPSHK-të jo të titulluara | Për EPSHK-të të titulluara | Për EPSHK-të e tregut | Totali | | | |
| | (1) | (2) | (3) | (4)=(1)+(2)+(3) | (5) | (6) | (7) | (8)=(5)+(6)+(7) | (9) | (10) | |
| Shqipëri | 400,000.00 | 120,000.00 | 14,000.00 | 534,000.00 | 50,000.00 | 15,000.00 | 2,900.00 | 67,900.00 | 69.71% | 1.00% | |
| B | 50,000.00 | 40,000.00 | | 90,000.00 | 6,500.00 | 5,000.00 | | 11,500.00 | 11.81% | 0.50% | |
| C | 60,000.00 | 20,000.00 | | 80,000.00 | 12,000.00 | 2,500.00 | | 14,500.00 | 14.89% | 1.00% | |
| D | 10,000.00 | 12,000.00 | | 22,000.00 | 2,000.00 | 1,500.00 | | 3,500.00 | 3.59% | 2.00% | |
| ... (lista zgjidhet sipas nevojës) | | | | | | | | | | | |
| TOTALI | 520,000.00 | 192,000.00 | 14,000.00 | 726,000.00 | 70,500.00 | 24,000.00 | 2,900.00 | 97,400.00 | 100.00% | | |

Shënim: Duke qenë se plotësohet kërkesa e nenit 12, paragrafi (7)(b), të rregullores "Për shesat makroprudenciale të kapitalit", EPK-të e tregut janë lokalizuar në juridiksionin vendas, për vlerën 6,500 mln lekë.

TABELA 2.1 Informacion plotësues për identifikimin e normave të AKUNC

| | |
|------------------------|-------------|
| Banka: | YYY |
| Niveli i zbatimit: | Individuele |
| Periudha e raportimit: | 3/31/2020 |

| Juridiksioni | Norma e AKUNC | Shpallur nga: | Data e shpalljes | Data e zbatimit | Adresa elektronike | Të tjera |
|--------------|---------------|--------------------|------------------|-----------------|-----------------------|----------|
| Shqipëri | 1.00% | Banka e Shqipërisë | 2/15/2019 | 2/15/2020 | www.bankofalbania.org | |
| B | 0.50% | Autoriteti B* | | | ... | |
| C | 1.00% | Autoriteti C* | | | ... | |
| D | 2.00% | Autoriteti D* | | | ... | |
| ... | ... | ... | | | | |

Shënimi: (*) Mund të jetë edhe Banka e Shqipërisë, nëse ajo ka shpallur një normë të AKUNC për juridiksionin e huaj, sipas nenit 12 të rregullores "Për shtesat makroprudenciale të kapitalit"

TABELA 3.1 Vlerat e SPEKUNC (duke iu referuar Tab. 1.1)

| | |
|------------------------|-------------|
| Banka: | YYY |
| Niveli i zbatimit: | Individuele |
| Periudha e raportimit: | Mars |
| Viti | 2018 |

| Elementi | Vlera |
|---|------------|
| Totali i ekspozimeve të peshuara me rrezik (EPR) | 850,000.00 |
| SPEKUNC (%) | 0.98% |
| Vlera absolute e Shtesës Kundërciklike të Kapitalit | 8,303.64 |

Shënimi: Të gjitha vlerat në tabela, janë të supozuara me qëllim instruktivim e plotësimit të tyre.

ANEKS 5. SHEMBULL

Midis dy bankave A dhe B, Banka A është një bankë e përcaktuar me rëndësi sistemike, të cilës, për këtë arsye, i takon të ketë një shtesë makroprudenciale të kapitalit (SIST) në masën 2%. Kjo shtesë ruhet përgjatë kohës. Të dy bankat gjenerojnë rezultat financiar pozitiv.

Gjithashtu, të dy bankat, i kanë ekspozimet e përshtatshme të kreditit ndaj sektorit privat, vetëm në Shqipëri. Në këtë rast, KUNC-i i shpallur nga Banka e Shqipërisë, është i njëjtë me AKUNC-in.

Supozojmë se Banka e Shqipërisë shpall SHMAK-un, duke rezultuar në vlerat si më poshtë:

Tabela 1

| Shtesa makroprudenciale e kapitalit, e shpallur nga BSH-ja | 1 janar 2020 | 1 janar 2021 | 1 janar 2022 | 1 janar 2023 | 1 janar 2024 |
|--|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|
| KONS = | 0.5% | 1.0% | 1.5% | 2.0% | 2.5% |
| SPEKUNC = | 0.0% | 1.0% | 1.0% | 1.0% | 1.0% |
| SIST ≥ | 0.5% | 1.0% | 1.5% | 2.0% | 2.0% |
| ASTRUK = | 0.0% | 0% | 1.0% | 1.5% | 1.5% |

Atëherë, SHKOMAK-u për bankën A (sistemike) dhe për bankën B do të jetë përkatësisht:

Tabela 2

| SHKOMAK | 1 janar 2020 | 1 janar 2021 | 1 janar 2022 | 1 janar 2023 | 1 janar 2024 |
|--|--------------|--------------|--------------|-------------------|--------------|
| Banka A (sistemike): KONS+SPEKUNC+SIST+ASTRUK | 1.0% | 3.0% | 5.0% | 6.5% ¹ | 7.0% |
| Banka B: KONS+SPEKUNC+ASTRUK | 0.5% | 2.0% | 3.5% | 4.5% | 5% |

Vërehet që gjatë gjithë periudhës, për bankën A (sistemike), plotësohet kushti që: "SIST + ASTRUK ≤ 4%" (neni 15, paragrafi 3(a) i projektit). Nëse kjo shumë do të ishte më e lartë, teprica do të pakësohej nga niveli i zbatueshëm i STRUK-ut (pra ASTRUK-u do të ishte më i vogël se STRUK-u i shpallur nga BSH-ja).

Supozojmë se më 1 janar 2021:

- Banka e Shqipërisë zbaton strukturën e mëposhtme të kapitalit për bankat:
 - CET1r ≥ 6.75%,
 - T1 ≥ 9%,
 - RMK ≥ 12%;
 -
- Banka A, përveç KMK, duhet të ketë edhe një shtesë kapitali të detyrueshme prej 1%, për shkak të profilit të saj të rrezikut (Shtylla II e Bazelit); Banka B, nuk e ka një të tillë;
- Banka A e raporton aktualisht treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit në vlerën 14.0%, ndërsa Banka B këtë tregues e ka në vlerën 16.25%;

- Banka A nuk përdor instrumente të kapitalit shtesë të nivelit të parë dhe të kapitalit të nivelit të dytë, ndaj kërkesat e saj për kapital plotësohen të gjitha me KBN1r. Ndërsa, në Bankën B, KBN1r është në nivelin 11%, dhe banka i përdor të gjitha instrumentet e mundshme të kapitalit shtesë të nivelit të parë dhe të kapitalit të nivelit të dytë.

Supozojmë se secila nga bankat i kërkon Bankës së Shqipërisë të kryejë një pagesë shpërndarjeje (dividend), në kushtet kur gjenerojnë të ardhura pozitive.

1) *Në ç'masë i përmbushin bankat A dhe B, kërkesat për SHKOMAK në datën 1 janar 2021?*

Banka A. Duke qenë se nuk ka instrumente të tjera të kapitalit, përveç atyre të kapitalit bazë të nivelit të parë, atëherë KBN1r duhet përdorur për të përmbushur fillimisht KMK dhe kërkesat e tjera të detyrueshme të kapitalit $(12\%+1\%) = 13\%$.

Pjesa e KBN1r që mbetet për të plotësuar SHKOMAK-un e bankës (prej 3.0%) është $KNDr = 1\%$ [KBN1r e raportuar (14%) – vlerën e KBN1r që duhet për të plotësuar KMK dhe kërkesat e tjera të detyrueshme të kapitalit (13%)].

Si rezultat, Banka A përmbush pjesërisht shtesën makroprudenciale të kapitalit, në nivelin $KNDr/SHKOMAK = [1\% / 3.0\%] = 33.3\%$.

Banka B. Pjesa e KBN1r, që mbetet për të plotësuar kërkesën për SHKOMAK për bankën (prej 2.0%) është $KNDr = 4.25\% = [KBN1r e raportuar (11\%) - vlerën e KBN1r që duhet për të plotësuar KMK dhe kërkesat e tjera të detyrueshme të kapitalit (6.75\%)].$

Si rezultat, Banka B e përmbush plotësisht shtesën makroprudenciale të kapitalit, në masën $KNDr/SHMAK = [4.25\% / 2.0\%] = 212.5\%$.

2) *A mund ta kryejnë secila nga bankat pagesën e shpërndarjes, dhe deri në ç'masë?*

Duke qenë se Banka A nuk e përmbush SHKOMAK-un, por gjeneron rezultat financiar pozitiv, atëherë pagesa mund të kryhet, por banka do të jetë subjekt i kufizimeve në pagesën e shpërndarjes, për shkak se plotëson pjesërisht kërkesën për SHKOMAK.

Duke iu referuar nenit 8, tabela 1, të rregullores, vërehet që niveli i KNDr për Bankën A, pozicionohet në kuartilin e dytë të SHKOMAK, dhe përqindja e pagesës së shpërndarjes është 20%. Si rezultat Banka A mund të shpërndajë si dividend vetëm deri në 20% të të ardhurave të gjeneruara.

Njëkohësisht, Bankës A do t'i kërkohet të paraqesë në Bankën e Shqipërisë një plan për fuqizimin e pozicionit të saj të kapitalit.

Ndërsa Banka B, duke qenë se e përmbush kërkesën për SHKOMAK-un, nuk ka kufizim në madhësinë e vlerës së pagesës së shpërndarjes.

3) Llogaritja e SPEKUNC-it, dhe më tej e (raportit të) përmbushjes së SHKOMAK-ut

Më tej, supozojmë se Banka B, vendos të zgjerojë me ritme të shpejta ekspozimet e saj jashtë Shqipërisë, konkretisht në juridiksionet X, Y dhe Z. Në këto kushte, Banka B do të duhet të llogarisë SPEKUNC-in, duke përdorur normat e KUNC-it të shpallura në këto juridiksione. Supozojmë se për muajin janar 2021, ato janë respektivisht nga 0.5%. Në këtë rast, llogaritjet e Bankës B kalojnë në hapat në vijim.

Tabela 3. Shpërndarja e ekspozimeve sipas juridiksioneve dhe llojit

| Ekspozimi | Lloji | Ekspozime të ponderuara me rrezikun (EPR): (Lek mln) | Ekspozimet e përshtatura të kreditit (EPSHK) | KPK (sipas Nenit 4, paragraf (1), nënparagraf. (30) të rreg. – e supozuar | Në % ndaj totalit të KPK |
|-----------|--------------------|--|--|---|--------------------------|
| (1) | (2) | (3) | (4) | (5) | (6) |
| Shqipëri | Kredi hipotekare | 1,000,000 | 1,000,000 | 80,000 | 18.7% |
| Shqipëri | Kredi biznesi | 3,000,000 | 3,000,000 | 240,000 | 56.0% |
| Shqipëri | Qeveria | 2,000,000 | | | |
| Shteti X | Retail | 50,000 | 50,000 | 4,000 | 0.9% |
| Shteti X | Kredi biznesi | 100,000 | 100,000 | 8,000 | 1.8% |
| Shteti X | Banka | 1,000,000 | | | |
| Shteti Y | Kartë krediti | 10,000 | 10,000 | 800 | 0.2% |
| Shteti Y | Titull korporate | 500,000 | 500,000 | 40,000 | 9.3% |
| Shteti Z | Kredi biznesi | 500,000 | 500,000 | 40,000 | 9.3% |
| Shteti Z | Kartë krediti | 70,000 | 70,000 | 5,600 | 1.3% |
| Shteti Z | Derivativ | 50,000 | 50,000 | 10,000 | 2.3% |
| Shteti Z | Kompani shtetërore | 100,000 | | | |
| | | | | | |
| Totali | | 8,380,000 | 5,280,000 | 428,400 | 100% |

Në këtë rast, duhet bërë edhe verifikimi nëse jemi në kushtet e nenit 13, paragrafi (6)(a). Vërehet që:

Tabela 4:

| Nr. | EPSHK-të në juridiksion të huaj | Vlera | Nr. | EPSHK-të sipas nenit 4, paragraf.(1)(29)(a)(iii) | Vlera |
|-----------|---|---------------|-----------|---|--|
| 1 | Shqipëri | | 1 | | |
| 2 | X | 150,000 | 2 | | |
| 3 | Y | 1,080,000 | 3 | | |
| 4 | Z | 570,000 | 4 | Derivativ | 50,000 |
| 5=2+3+4 | Totali i EPSHK-ve në juridiksion të huaj | 1,800,000 | 5=1+2+3+4 | Totali | 50,000 |
| 6 | Totali i EPSHK-ve | 5,730,000 | 6 | Totali i EPSHK-ve | 5,280,000 |
| 7=5/6*100 | Raporti | 31.4% | 7=5/6*100 | Raporti | 0.95% |
| 8 | Vlera sipas nenit 13, paragraf. (6) (a)(i) | 2% | 8 | Vlera kufi sipas nenit 13, paragraf. (6)(a)(iii) | 2% |
| 9 | Nëse nr.7 ≤ nr.8, MUND të veprohet sipas nenit 13, paragraf.(6) (c) | Nuk ka veprim | 9 | Nëse nr.7 ≤ nr.8, MUND të veprohet sipas nenit 13, paragraf.(6) (c) | Banka zgjedh të përfshijë eksp e derivativit tek Shqipëria |

Si rezultat, nuk plotësohet kushti i nenit 13, paragrafi (6) (a)(i), por plotësohet ai i nenit 13, paragrafi (6)(a)(ii). Në vijim, banka zgjedh ta përfshijë vlerën e ekspozimit të Derivativit (50,000 ALL), si ekspozim në juridiksionin e bankës, pra si ekspozim në Shqipëri.

Tabela 5. Përcaktimi i AKUNC

| Shteti/Juridiksioni | Autoriteti i vendit | KUNC | AKUNC (2021) | Komente |
|---------------------|---------------------|------|--------------|---------------|
| Shqipëri | BSH | 1% | 1% | Shiko Tabelën |
| X | Alfa | 0.5% | 0.5% | |
| Y | Beta | 0.5% | 0.5% | |
| Z | Gama | 0.5% | 0.5% | |

Tabela 6: Përcaktimi i SPEKUNC¹

| Shteti/Juridiksioni | Në % ndaj totalit të KPK-ve | AKUNC | SPEKUNC |
|---------------------|-----------------------------|-------|---------------|
| (1) | (2) | (3) | (4) = (2)*(3) |
| Shqipëri | 77%* | 1% | 0.77% |
| X | 2.7% | 0.5% | 0.01% |
| Y | 9.5% | 0.5% | 0.05% |
| Z | 10.6% | 0.5% | 0.05% |
| Totali | 100% | | 0.9% |

* - këtu përfshihet edhe ekspozimi i Derivatit (pesha 2.3%).

Në këto kushte, **vlera absolute e shtesës kundërciklike** të kapitalit për Bankën B, sipas nenit 11, paragrafi (6) (b), do të jetë: $SPEKUNC * EPR = 0.9% * 8,380,000 = 75,420$ lekë.

Ndërsa, niveli i SHKOMAK-ut për Bankën B do të jetë:

$SHKOMAK (B) = (KONS: 1.0\%) + (SPEKUNC: 0.9\%) + (ASTRUK: 0\%) = 1.9\%$

Duke llogaritur KNDr për Bankën B dhe duke e vënë në raport me SHMAK-un (sipas paragrafit 1), gjejmë raportin e përmbushjes së SHKOMAK-ut, i cili më pas përcakton edhe mundësinë e bankës për të kryer ose jo një pagesë shpërndarjeje, dhe ndoshta edhe kërkesën për një plan fuqizimi të pozicionit të saj të kapitalit.

Në vijim, duke qenë se këto tre juridiksione të huaja po përjetojnë rritje të shpejtë ekonomike dhe zgjerim të shpejtë të kreditit, Banka e Shqipërisë i vlerëson rreziqet si të larta ndaj vendos të shpallë që për secilin prej tyre AKUNC-i do të jetë 1.5% (me datë efektive në janar 2022). Këto norma do të shërbejnë tashmë si AKUNC për bankën. Atëherë, në janar 2022, do të kemi të dhënat sipas Tabelës 7.

Tabela 7

| Shteti/Juridiksioni | EPCHK-të | Në % ndaj totalit të KPK-ve | KUNC | AKUNC | SPEKUNC | Koment |
|---------------------|-----------|-----------------------------|------|-------|---------------|---|
| (1) | (2) | (3) | (4) | (5) | (6) = (3)*(5) | |
| Shqipëri | 4,000,000 | 68.8% | 1% | 1% | 0.7% | Gjatë një viti, ekspozimi për Shqipërinë (Kol (2)) nuk ka ndryshuar |
| X | 200,000 | 3.4% | 0.5% | 1.5%* | 0.05% | Gjatë një viti, ekspozimi për X është rritur në këtë vlerë |
| Y | 810,000 | 13.9% | 0.5% | 1.5% | 0.2% | Gjatë një viti, ekspozimi për Y është rritur në këtë vlerë |
| Z | 800,000 | 13.8% | 0.5% | 1.5% | 0.2% | Gjatë një viti, ekspozimi për Z është rritur në këtë vlerë |
| Totali | 5,810,000 | 100% | | | 1.15% | |

*Norma e KUNC-it që ka shpallur BSH-në, është më e lartë se në juridiksionin e huaj.

¹ Për më shumë, referojuni sqarimeve të EBA, në adresën: http://www.eba.europa.eu/single-rule-book-qa/-/qna/view/publicId/2016_3055

Në këto kushte, për Bankën B, niveli i SHKOMAK-ut në janar 2022, do të jetë:

$$\text{SHKOMAK (B)} = (\text{KONS: } 1.5\%) + (\text{SPEKUNC: } 1.15\%) + (\text{ASTRUK: } 1\%) = 3.65\%$$

Duke llogaritur KNDr për Bankën B dhe duke e vënë në raport me SHKOMAK-un (sipas paragrafit 1), gjejmë raportin e përmbushjes së SHKOMAK-ut, i cili më pas përcakton edhe mundësinë e bankës për të kryer ose jo një pagesë shpërndarjeje, dhe ndoshta edhe kërkesën për një plan fuqizimi të pozicionit të saj të kapitalit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM
Nr. 42, datë 5.6.2019

PËR
REVOKIMIN E LICENCËS SË BANKËS SË KREDITIT TË SHQIPËRISË SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja "e", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë"; të nenit 107, pika 2, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; si dhe pasi u njoh me vendimin datë 22.1.2019 të Asamblesë së Aksionerëve të Bankës së Kreditit të Shqipërisë sh.a.; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të revokojë licencën nr.15, datë 28.8.2002, të Bankës së Kreditit të Shqipërisë sh.a., për shkak të fillimit të procesit të likuidimit vullnetar nga ana e vetë bankës.
2. Ngarkohet Banka e Kreditit të Shqipërisë sh.a. të dorëzojë pranë Bankës së Shqipërisë licencën e revokuar.
3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e procesit të likuidimit vullnetar të Bankës së Kreditit të Shqipërisë sh.a., deri në përfundimin e tij dhe njoftimin e këtij vendimi Agjencisë të Sigurimit të Depozitave.
4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM
Nr. 44, datë 5.6.2019

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES
“VLERËSIMI PËR QËLLIMET E NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; si edhe të nenit 24, pika 14, nenit 36, pika 6 dhe nenit 57, pika 4 të ligjit nr. 133/2016, datë 22.12.2016 “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë”; me propozim të Departamentit për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Vlerësimi për qëllimet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme në Bankën e Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

SEKRETARI

KRYETARI

ELVIS ÇIBUKU

GENT SEJKO

KREU I TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i:

1. kritereve, kushteve dhe mënyrës së zgjedhjes së vlerësuesit të pavarur për qëllime të ndërhyrjes së jashtëzakonshme;
2. mënyrës së kryerjes së vlerësimit sipas nenit 24, pika 5 të ligjit nr.133/2016, datë 22.12.2016 "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë";
3. metodologjisë për vlerësimin e diferencës në mënyrën e trajtimit, për të përcaktuar nëse aksionarët dhe kreditorët do të ishin në një pozitë më të favorshme në rast se do të kishte filluar procedura e likuidimit të detyruar në vend të procedurës së ndërhyrjes së jashtëzakonshme, sipas nenit 57 të ligjit nr. 133/2016, datë 22.12.2016 "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë";
4. metodologjisë për përcaktimin e vlerës së detyrimeve që rrjedhin nga produktet derivative sipas nenit 36 të ligjit nr. 133/2016, datë 22.12.2016 "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë".

Neni 2 Subjektet

Subjekte zbatuese të kësaj rregulloreje janë:

- a. subjektet që mund të përzgjidhen për të ushtruar funksionin e vlerësuesit, sipas kësaj rregulloreje;
- b. bankat dhe degët e bankave të huaja, të licencuara nga Banka e Shqipërisë.

Neni 3 Baza ligjore

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të:

- a. nenit 43, shkronja "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- b. nenit 24, pika 14, nenit 36, pika 6 dhe nenit 57, pika 4 të ligjit nr.133/2016, datë 22.12.2016 "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë".

Neni 4 Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar ose të përdorur në:
 - a. ligjin nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar;
 - b. ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
 - c. ligjin nr. 133/2016, datë 22.12.2016 "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë", në vijim ligji nr. 133/2016.
2. Përveç sa parashikohet në pikën 1, për qëllime të zbatimit në këtë rregullore, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:
 - a. Vlerësim nënkupton procesin e vlerësimit të aktiveve dhe detyrimeve të bankës, i kryer nga një vlerësues i pavarur sipas pikës 1, neni 24 i ligjit nr. 133/2016 ose vlerësimi i përkohshëm i kryer nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme ose vlerësuesi sipas pikave 2 dhe 8, neni 24 i ligjit nr. 133/2016;
 - b. Vlerësues është vlerësuesi i pavarur, i cili plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 5 të kësaj rregulloreje;
 - c. Vlera e drejtë është çmimi që merret nga shitja e një aktivi ose paguhet për transferimin e një detyrimi në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut në datën e vlerësimit, bazuar në legjislacionin në fuqi;
 - d. Vlera e mbajtjes është vlera aktuale e flukseve të pritshme të mjeteve monetare të bankës nga aktivet dhe detyrimet që disponon, që priten në mënyrë të arsyeshme, sipas supozimeve të drejta, të kujdeshme dhe realiste, e skontuar sipas një norme të përshtatshme, duke marrë parasysh faktorët që ndikojnë në sjelljen e klientit ose të kundërpalëve ose parametrave të tjerë të vlerësimit në kuadër të ndërhyrjes së jashtëzakonshme;
 - e. Bazë matjeje është mënyra e përcaktimit të shumave monetare në të cilën paraqiten aktivet ose detyrimet nga vlerësuesi;
 - f. Vlera e mbetur për nxjerrjen jashtë përdorimit përcaktohet nga vlerësuesi në bazë të flukseve të mjeteve monetare, duke zbritur kostot e nxjerrjes nga përdorimi dhe vlerën e pritshme të ndonjë garancie të dhënë, që banka mund të presë në mënyrë të arsyeshme, në kushtet aktuale të tregut, nëpërmjet një shitjeje të rregullt ose nëpërmjet transferimit të aktiveve ose detyrimeve;
 - g. Vlera e franshizës nënkupton vlerën aktuale neto të pritshme të flukseve të mjeteve monetare si rezultat i mirëmbajtjes dhe rinovimit të aktiveve dhe detyrimeve ose bizneseve dhe përfshin ndikimin e çdo mundësie biznesi, sipas rastiit, përfshirë edhe ato mundësi që rrjedhin nga veprime të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe që vlerësohen nga vlerësuesi. Vlera e franshizës mund të jetë më e lartë ose më e ulët se vlera që rrjedh

- nga kushtet kontraktuale të aktiveve dhe detyrimeve ekzistuese në datën e vlerësimit;
- h. Vlera e kapitalit aksionar është çmimi i vlerësuar i tregut për aksionet e transferuara ose të emetuara, që rrjedh nga metodologjitë e vlerësimit të pranuarra gjerësisht. Bazuar në natyrën e aktiveve ose biznesit, vlera e kapitalit mund të përfshijë vlerën e franshizës;
 - i. Data e vlerësimit është data referencë për vlerësimin sipas nenit 11 të kësaj rregulloreje;
 - j. Data e vendimit për ndërhyrjen e jashtëzakonshme nënkupton datën në të cilën Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme miraton vendimin për ndërhyrjen e jashtëzakonshme në një bankë, sipas nenit 65 të ligjit nr.133/2016;
 - k. Datë e mbylljes është dita dhe ora e përfundimit të marrëveshjeve të produkteve derivative, e përcaktuar nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme në vendimin për përfundimin e marrëveshjeve për produktet derivative;
 - l. Transaksioni i zëvendësimit nënkupton një transaksion të lidhur në ose pas datës së mbylljes së një kontrate derivative, për të rivendosur pozicionin e mbrojtjes ose pozicionin e tregtimit të ndërprerë, mbi bazën e ekspozimit neto ndaj rrezikut me kushte ekonomike të ngjashme me ato në transaksionin close-out;
 - m. Transaksion zëvendësues i arsyeshëm nënkupton një transaksion zëvendësimi të lidhur në bazë të ekspozimit neto ndaj rrezikut, në përputhje me praktikat e përbashkëta të tregut dhe duke bërë përpjekje të arsyeshme për të fituar vlerën më të mirë të parave.

KREU II

KRITERET PËR PËRZGJEDHJEN E VLERËSUESIT PËR QËLLIME TË NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME

Neni 5

Elementet e pavarësisë

- 1. Vlerësuesi për qëllime të ndërhyrjes së jashtëzakonshme mund të jetë person juridik ose person fizik.
- 2. Në ushtrimin e funksionit të tij, sipas ligjit nr. 133/2016, vlerësuesi duhet të jetë i pavarur nga banka subjekt i ndërhyrjes së jashtëzakonshme, nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe çdo autoritet publik;
- 3. Vlerësuesi është i pavarur sipas pikës 2, kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:
 - a. zotëron kualifikimet, përvojën, aftësitë, njohuritë dhe burimet e kërkuara me qëllim kryerjen e vlerësimit në mënyrë efektive pa u mbështetur te banka, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe çdo autoritet publik në përputhje me nenin 6 të kësaj rregulloreje;

- b. nuk ka marrëdhënie juridike dhe financiare me Autoritetin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe çdo autoritet publik, si dhe me bankën për të cilën bëhet vlerësimi ose grupi bankar pjesë e të cilit është banka, në përputhje me nenin 7 të kësaj rregulloreje;
- c. nuk është në kushtet e konfliktit të interesit sipas nenit 8 të kësaj rregulloreje.

Neni 6

Kualifikimet, përvoja, aftësitë, njohuritë dhe burimet e kërkuara

- 1. Vlerësuesi duhet të zotërojë kualifikimet, përvojën, aftësitë dhe njohuritë e nevojshme në të gjitha çështjet që konsiderohen thelbësore nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.
- 2. Vlerësuesi duhet të ketë në dispozicion burime njerëzore dhe aftësi teknike të nevojshme për të kryer në mënyrë të përshtatshme vlerësimin, duke marrë në konsideratë natyrën, qëllimin dhe kompleksitetin e tij.
- 3. Me qëllim kryerjen e vlerësimit, vlerësuesi nuk duhet:
 - a. të kërkojë ose të marrë udhëzime, nga banka, nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe çdo autoritet publik;
 - b. të kërkojë ose të pranojë ndonjë përfitim financiar ose çdo përfitim tjetër, nga banka, nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe çdo autoritet publik.
- 4. Zbatimi i pikës 3 nuk e pengon vlerësuesin:
 - a. të marrë udhëzime ose rekomandime, ambiente, pajisje teknike ose forma të tjera të mbështetjes, nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, kur ky i fundit e konsideron të nevojshme për arritjen e objektivave të vlerësimit të pavarur;
 - b. të paguhet për vlerën e shërbimit dhe të shpenzimeve të nevojshme për kryerjen e procesit të vlerësimit.

Neni 7

Ndarja strukturore

- 1. Me qëllim zbatimin e nenit 5, pika 3, shkronja "b" të kësaj rregulloreje, vlerësuesi duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:
 - a. në rastin kur vlerësuesi është person fizik, ai nuk është punonjës ose i kontraktuar nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, ndonjë autoritet publik, si dhe nga banka për të cilën bëhet vlerësimi ose grupi bankar pjesë e të cilit është banka;
 - b. në rastin kur vlerësuesi është person juridik, ai nuk i përket të njëjtit grup/shoqëri/organizatë me Autoritetin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, me ndonjë autoritet publik, si dhe me bankën për të cilën bëhet vlerësimi ose grupin bankar, pjesë e të cilit është banka.

Neni 8 Konflikti i interesit

1. Vlerësuesi nuk duhet të ketë konflikt faktik ose të mundshëm interesi, me bankën, Autoritetin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe çdo autoritet publik.
2. Për qëllimet e pikës 1, prania e interesit faktik ose të mundshëm do të konsiderohet si konflikt interesi, kur sipas vlerësimit të Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, ndikon ose mund të ndikojë në gjykimin e vlerësuesit në kryerjen e vlerësimit.
3. Për qëllimet e pikës 1, konsiderohet konflikt interesi, lidhja me të paktën një nga palët e mëposhtme:
 - a. drejtuesit e lartë dhe anëtarët e këshillit drejtues të bankës;
 - b. personat juridikë ose fizikë që kontrollojnë ose kanë shumicën zotëruese në bankë ose grupin bankar pjesë e të cilit është banka;
 - c. kreditorët e rëndësishëm të identifikuar si të tillë mbështetur në informacionin në dispozicion të Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme;
 - d. secilin subjekt tjetër të grupit bankar.
4. Për qëllimet e pikës 1, konsiderohen gjithashtu edhe çështjet e mëposhtme:
 - a. ofrimi i shërbimeve nga vlerësuesi, që përfshin ofrimin e shërbimeve në të kaluarën, për bankën dhe personat e përmendur në pikën 3, dhe në veçanti lidhjen midis këtyre shërbimeve me elementet e rëndësishme për vlerësimin;
 - b. marrëdhëniet personale dhe financiare ndërmjet vlerësuesit dhe bankës, si dhe personave të përmendur në pikën 3;
 - c. investimet ose interesat të tjera materiale financiare të vlerësuesit;
 - d. në rastin e personit juridik, çdo marrëdhënie juridike dhe financiare ose marrëveshje tjetër që do të realizohet për të trajtuar çdo element që mund të cenohet pavarësisht si p.sh., rishqyrtimi i vlerësimeve/auditimeve të mëparshme, interesat financiare, mbrojtja, familjariteti, marrëdhëniet e besimit ose kërcënimit, përfshirë marrëveshjet për të dalluar anëtarët e stafit (që mund të marrin pjesë në vlerësim) nga anëtarët e tjerë të stafit.
5. Përveç sa parashikohet në pikat 3 dhe 4, vlerësuesi konsiderohet se është në kushtet e konfliktit të interesit, në rast se një vit përpara datës në të cilën zgjidhet të veprojë si vlerësues ka kryer një auditim ligjor në atë bankë.
6. Çdo person që konsiderohet për pozicionin e vlerësuesit ose emërohet si vlerësues duhet:
 - a. të zbatojë në përputhje me kodet e etikës dhe standardet profesionale, politikat dhe procedurat për të identifikuar çdo interes faktik ose të mundshëm, në përputhje me pikën 2;

- b. të njoftojë menjëherë Autoritetin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për çdo interes faktik ose të mundshëm të cilin vlerësuesi e mendon të tillë, i cili sipas vlerësimit të Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, mund të konsiderohet si konflikt interesi sipas pikës 2;
- c. të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të siguruar që asnjë anëtar i personelit ose të tjerë të përfshirë në kryerjen e vlerësimit, nuk kanë ndonjë interes faktik ose të mundshëm sipas pikës 2.
- d. të deklarojë me shkrim për Autoritetin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme që plotëson kushtet e këtij neni për të ushtruar i pavarur funksionin e vlerësuesit.

Neni 9 Përzgjedhja e vlerësuesit

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme përzgjedh vlerësuesin për të kryer vlerësimin, bazuar në pikën 11 të nenit 24, të ligjit nr. 133/2016.
2. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme shqyrton dokumentacionin e paraqitur në përputhje me kushtet dhe kriteret e kësaj rregulloreje.
3. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, në raste të veçanta, mund të vendosë kriteret shtesë, të cilat duhet të përmbushen nga vlerësuesi në mënyrë që të përzgjidhet për të kryer vlerësimin, përfshirë koston e angazhimit si dhe kapacitetet e tij operationale, teknike dhe të personelit.
4. Bazuar në këtë rregullore, Autoriteti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme lidh një marrëveshje me vlerësuesin për kryerjen e vlerësimit, e cila përcakton mes të tjerash, subjektin e vlerësimit, afatin për dorëzimin e raportit të vlerësimit të kryer, klauzolën e konfidencialitetit që i referohet subjektit të vlerësimit dhe elemente të tjera.

KREU III VLERËSIMI PËR QËLLIME TË NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME

Neni 10 Kërkesa kryesore

1. Gjatë kryerjes së vlerësimit, vlerësuesi merr në konsideratë rrethanat që ndikojnë në flukset monetare të pritshme dhe normat e skontimit të zbatueshme për aktivet dhe detyrimet e bankës dhe paraqet në mënyrë të drejtë pozicionin financiar të bankës nga pikëpamja e mundësive dhe rreziqeve që ajo ka ndërmarrë.
2. Vlerësuesi komunikon dhe argumenton supozimet kryesore të përdorura në vlerësim. Çdo shmangie e rëndësishme në vlerësim, nga supozimet e përdorura nga administratorët e bankës në përgatitjen e pasqyrave financiare dhe në llogaritjen e kapitalit rregullator dhe të kërkesave për kapital të bankës, duhet të bazohet në informacionin më të mirë në dispozicion.

3. Vlerësuesi jep vlerësimin më të mirë për vlerën e një aktivi, detyrimi ose kombinimi të tyre. Kur është e përshtatshme, rezultatet e vlerësimit mund të paraqiten edhe në formën e një intervali vlerash.
4. Kriteret e përcaktuara në këtë rregullore për vlerësimin e aktiveve dhe detyrimeve individuale të një banke, zbatohen gjithashtu edhe për vlerësimin e portofoleve ose grupeve të aktiveve dhe detyrimeve, ose të aktiveve dhe detyrimeve të konsoliduara, aktiviteteve tregtare apo subjekteve që konsiderohen si një e tërë, në varësi të rrethanave.
5. Vlerësuesi i ndan kreditorët në kategori sipas radhës së shlyerjes së detyrimeve në bazë të legjislacionit dhe praktikës së përdorur në likuidimin e detyruar në juridiksionin përkatës dhe përfshin vlerësimet e mëposhtme:
 - a. vlerën e detyrimeve të secilës kategori, në rastin e fillimit të procedurave të likuidimit të detyruar dhe aty ku është e mundur dhe e realizueshme, sipas të drejtave kontraktuale që i janë dhënë secilës kategori;
 - b. përfitimet e mundshme që do të mernte secila kategori, nëqoftëse do të zbatohej likuidimi i detyruar.

Kur llogaritet vlerësimi sipas shkronjave "a" dhe "b", vlerësuesi mund të zbatojë kriteret e përcaktuara në nenin 26 të kësaj rregulloreje, sipas rastit.

6. Kur është e përshtatshme dhe e mundshme, duke marrë parasysh kohën në dispozicion dhe objektivin për besueshmërinë e vlerësimit, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme mund të kërkojë disa vlerësime nga vlerësuesi. Në këtë rast, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme vendos kriteret për të përcaktuar se cili nga vlerësimet do të përdoret për qëllimet e nenit 24 të ligjit nr. 133/2016.

Neni 11 **Data e vlerësimit**

1. Data e vlerësimit është një nga datat e mëposhtme:
 - a. data e referencës siç përcaktohet nga vlerësuesi, mbështetur në datën më të afërt të mundshme përpara datës së marrjes së vendimit të Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për vendosjen e bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme ose për ushtrimin e kompetencës së zhvlerësimit dhe konvertimit të instrumenteve të kapitalit;
 - b. data e vendimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, në rastin e kryerjes së një vlerësimi përfundimtar *ex-post*, sipas pikës 9, neni 24 të ligjit nr. 133/2016.
2. Në lidhje me detyrimet që rrjedhin nga kontratat derivative, data e vlerësimit është data e mbylljes së kontratës ose nëse kjo datë nuk është një ditë tregtimi, përdoret dita dhe ora në të cilën ekziston një çmim i disponueshëm në tregun e derivativeve. Kur vlerësuesi përcakton shumën e përfundimit të parakohshëm të kontratës derivative, me çmimet e

transaksioneve zëvendësuese sipas pikës 1, neni 33 të kësaj rregulloreje, data e vlerësimit është dita dhe ora e përfundimit të transaksionit zëvendësues.

Neni 12 Burimet e informacionit

Vlerësimi bazohet në të gjitha të dhënat dhe informacionet e disponueshme deri në datën e vlerësimit. Përveç pasqyrave financiare të bankës, raporteve të auditimit dhe raportimit rregullator për datën e vlerësimit ose për periudhën më të afërt me të, ky informacion mund të përfshijë:

- a. pasqyrat financiare të përditësuara dhe raportimet rregullative të përgatitura nga banka sa më afër që është e mundur me datën e vlerësimit;
- b. një shpjegim të metodologjive, supozimeve dhe gjykimeve kryesore të përdorura nga banka për mënyrën e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe raportimin rregullator;
- c. të dhënat që gjenden në regjistrat e bankës;
- d. të dhënat përkatëse të tregut;
- e. përfundime të nxjerra nga vlerësuesi sipas diskutimeve të kryera me drejtuesit dhe auditorët e bankës;
- f. vlerësimet mbikëqyrëse të gjendjes financiare të bankës duke përfshirë informacionin sipas, shkronjës "dh" pika 1, neni 17, të ligjit nr. 133/2016;
- g. vlerësimet për cilësinë e aktiveve të sektorit bankar dhe veçanërisht për aktivet e subjektit dhe rezultatet e provës së rezistencës;
- h. vlerësime të ngjashme të kryera nga vlerësues të tjerë të pavarur ose vlerësime të tjera të njëjta, të përshtatura në mënyrë të tillë për të përfshirë rrethanat e veçanta të bankës;
- i. informacion historik, të përshtatur në mënyrë të tillë që të përjashtojë faktorët që nuk janë më të rëndësishëm dhe të përfshijë të tjerë që nuk kanë ndikuar në informacionin historik; ose
- j. analizat e trendit, të përshtatura në mënyrë që të pasqyrojnë rrethanat specifike të bankës.

Neni 13 Ndikimi i marrëveshjes së grupit

1. Kur banka është pjesë e një grupi bankar, vlerësuesi merr parasysh ndikimin që mund të kenë marrëveshjet ekzistuese të mbështetjes financiare brenda grupit, mbi vlerën e aktiveve dhe detyrimeve, nëse në bazë të rrethanave është e mundur që këto marrëveshje të hyjnë në fuqi.
2. Vlerësuesi merr parasysh ndikimin e marrëveshjeve të tjera formale ose joformale brenda grupit, vetëm kur në bazë të rrethanave është e mundur që këto marrëveshje të mbeten në fuqi në kuadër të gjendjes së rënduar financiare të grupit ose gjatë ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

3. Vlerësuesi përcakton nëse burimet financiare të bankës brenda grupit mund të përdoren për të përthithur humbjet e subjekteve të tjera të grupit.

Neni 14 Raporti i vlerësimit

Vlerësuesi përgatit një raport vlerësimi për Autoritetin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, i cili krahas elementeve të përmendura në pikat 6 dhe 7 të nenit 24 të ligjit nr.133/2016, përfshin të paktën elementet në vijim:

- a. vlerësimin se çfarë trajtimi do të merrte secila kategori e aksionarëve dhe kreditorëve, nëse banka do të vendosej në likuidim të detyruar;
- b. vlerësimin e detyrimeve që rrjedhin nga derivativët në përputhje me Kreun VII në këtë rregullore;
- c. një përmbledhje të procesit të vlerësimit duke përfshirë diskutimin e vlerësimit të vlerës më të mirë, intervalet e vlerave si dhe burimet e pasigurisë në vlerësim;
- d. një shpjegim të metodologjive dhe supozimeve kryesore të përdorura nga vlerësuesi gjatë kryerjes së vlerësimit, si dhe ndjeshmërinë e vlerësimit ndaj këtyre zgjedhjeve dhe aty ku është e mundur, një shpjegim se si këto metodologji dhe supozime ndryshojnë nga ato të përdorura për vlerësime të tjera të ngjashme, duke përfshirë vlerësimet e përkohshme të ndërhyrjes së jashtëzakonshme;
- e. çdo informacion shtesë që sipas mendimit të vlerësuesit do të ndihmonte Autoritetin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për qëllimet e nenit 24 të ligjit nr.133/2016.

KREU IV VLERËSIMI PËR PLOTËSIMIN E KUSHTEVE PËR NDËRHYRJEN E JASHTËZAKONSHME

Neni 15 Kërkesa kryesore

1. Përpara marrjes së vendimit nëse janë plotësuar kushtet për fillimin e procedurës së ndërhyrjes së jashtëzakonshme, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme siguron që të kryhet një vlerësim i drejtë, i kujdesshëm dhe realist i vlerës së aktiveve dhe detyrimeve të bankës nga një vlerësues i pavarur nga banka, nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe nga çdo autoritet tjetër publik, i përzgjedhur në përputhje me kërkesat e Kreut II të kësaj rregulloreje.
2. Vlerësimi për qëllimet e nenit 24, pika 5, shkronja "a", të ligjit nr.133/2016 duhet të bazohet në supozime të drejta dhe realiste dhe duhet të sigurojë që humbjet nën skenarin e duhur të njihen plotësisht. Ky vlerësim do t'i shërbejë Bankës së Shqipërisë si Autoritet Mbikëqyrës dhe i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, për marrjen e vendimit që banka

është në kushtet e paaftësisë paguese, në përputhje me nenin 21, pika 1, shkronja "a", të ligjit nr.133/2016. Bazuar në udhëzimet mbikëqyrëse ekzistuese ose burimet e tjera gjerësisht të pranuar, të cilat përcaktojnë kriteret që ndihmojnë vlerësimin e drejtë dhe realist të llojeve të ndryshme të aktiveve dhe detyrimeve, vlerësuesi mund të gjykojë mbi cilësinë e të dhënave, metodologjitë dhe gjykimet e përdorura nga banka në vlerësimet e saj për qëllime të raportimit financiar ose për llogaritjen e kapitalit rregullator dhe të kërkesave për kapital, dhe mund të mos i marrë në konsideratë për qëllime të kryerjes së vlerësimit.

3. Vlerësuesi përcakton metodologjitë më të përshtatshme të vlerësimit, të cilat mund të mbështeten në modelet e brendshme të bankës kur vlerësuesi e gjykon të përshtatshme, duke marrë parasysh natyrën e strukturës së administrimit të rrezikut të bankës dhe cilësinë e të dhënave dhe informacionit në dispozicion.
4. Vlerësimet përfundimtare duhet të jenë në përputhje me kuadrin e zbatueshëm kontabël dhe me kuadrin rregullator duke përfshirë edhe këtë rregullore.

Neni 16

Fushat që kërkojnë vëmendje të veçantë në vlerësim

Gjatë kryerjes së vlerësimit, vlerësuesi i kushton vëmendje të veçantë fushave në të cilat ka pasiguri të rëndësishme, të cilat kanë një ndikim të konsiderueshëm në vlerësimin e përgjithshëm. Për këto fusha, vlerësuesi ofron rezultatet e vlerësimit në formën e vlerësimit më të mirë dhe sipas rastit, në formën e intervaleve të vlerave, siç përcaktohet në pikën 3, neni 10 në këtë rregullore. Këto fusha përfshijnë:

- a. kreditë ose portofolet e kredisë, flukset e pritshme monetare të të cilave varen nga aftësia, vullneti ose motivimi i një pale të tretë për përmbushjen e detyrimit të saj, ku këto pritshmëri ngrihen nga supozimet në lidhje me normat e mospagimit/moskthimit, probabilitetin e paaftësisë paguese, karakteristikat e instrumentit, veçanërisht kur evidentohen nga një historik humbjesh për një portofol kredish;
- b. aktivet e rimarra, flukset monetare të të cilave ndikohen nga vlera e drejtë e aktivitetit në kohën që banka merr kolateralin përkatës për shkak të mospagimit të huasë, si dhe e ardhmja e pritshme e kësaj vlere pas këtij momenti;
- c. instrumentet e matura me vlerën e drejtë, ku përcaktimi i kësaj vlere në përputhje me kërkesat kontabël ose rregullatore për përcaktimin e çmimit të tregut të tyre ose çmimit sipas modeleve financiare, nuk është më e zbatueshme ose e vlefshme duke marrë parasysh rrethanat;
- d. emri i mirë dhe aktivet e patrupëzuara, ku prova/testi i përkeqësimit mund të varet nga gjykimi subjektiv, që lidhet me një rrjedhë të arsyeshme të flukseve monetare, normat e skontimit dhe perimetrin e njësisive që gjenerojnë mjete monetare;

- e. mosmarrëveshjet ligjore dhe veprimet rregullatore, flukset monetare të pritshme të cilave mund të jenë subjekt i një shkalle të ndryshme pasigurie në lidhje me shumën dhe/ose kohën e tyre;
- f. zërat që përfshijnë aktivet dhe detyrimet e pensioneve dhe zërat e tatimit të shtyrë, sipas rastit.

Neni 17 Faktorët që ndikojnë në vlerësim

1. Vlerësuesi merr parasysh faktorët e përgjithshëm që ndikojnë në supozimet kryesore në të cilat bazohen vlerat e aktiveve dhe detyrimeve në fushat e përmendura në nenin 16 të kësaj rregulloreje, duke përfshirë faktorët e mëposhtëm:
 - a. kushtet makroekonomike dhe gjendja në treg që mund të ndikojnë në veprimtarinë e bankës;
 - b. modelin e biznesit të bankës dhe ndryshimet në strategjinë e saj;
 - c. kriteret e përzgjedhjes së aktiveve të bankës, duke përfshirë politikat e garantimit të kredive;
 - d. rrethanat dhe praktikatat që mund të çojnë në një krizë të pagesave;
 - e. rrethanat që ndikojnë në parametrat e përdorur për të përcaktuar aktivet e ponderuara me rrezikun për llogaritjen e kërkesave minimale për kapital;
 - f. ndikimin e strukturës financiare të bankës në kapacitetin e bankës për të mbajtur aktivet për një periudhë të pritshme dhe aftësinë e bankës për të prodhuar flukse monetare të parashikueshme;
 - g. probleme të përgjithshme ose të veçanta të likuiditetit ose financimit të bankës.
2. Vlerësuesi duhet të veçojë në mënyrë të qartë çdo fitim të rëndësishëm të papërfshirë në procesin e vlerësimit, në masën që ky fitim nuk është njohur në vlerësim, dhe të sigurojë informacionin e duhur në raportin e vlerësimit për rrethanat e jashtëzakonshme që kanë çuar në këto fitime.

KREU V VLERËSIMI PËR ZGJEDHJEN E INSTRUMENTIT TË NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME

Neni 18 Kritere kryesore

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme pasi përcakton se një bankë i plotëson kushtet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, siguron nëpërmjet këtij vlerësimi informacion të nevojshëm në lidhje me zgjedhjen e instrumentit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, të përshtatshëm për t'u zbatuar në bankë, si dhe kushtet për ushtrimin e kompetencës së zhvlerësimit e të konvertimit, si dhe vendime të tjera për zbatimin e instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, që duhet të marrin në konsideratë ndikimin (akoma hipotetik) të veprimeve që mund të merren nga Autoriteti

i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, në zbatimin e strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

2. Vlerësuesi vlerëson ndikimin e çdo veprimi të ndërhyrjes së jashtëzakonshme që mund të marrë Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, në mënyrë që t'i japë informacionin e nevojshëm në lidhje me çështjet e përmendura në shkronjat "b" deri "e" të pikës 5, të nenit 24 të ligjit nr.133/2016. Pa cenuar pavarësinë e vlerësuesit, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme mund të konsultohet me vlerësuesin për të identifikuar tërësinë e veprimeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme që konsiderohen nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, duke përfshirë veprimet e parashikuara në planin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, ose nëse është ndryshe, çdo skeme të propozuar të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.
3. Për të siguruar një vlerësim të drejtë, të kujdesshëm dhe realist, kur është e përshtatshme dhe në konsultim me Autoritetin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, vlerësuesi paraqet vlerësime të veçanta që pasqyrojnë ndikimin e një numri të mjaftueshëm të veprimeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.
4. Vlerësuesi siguron që kur zbatohen instrumentet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme ose kur ushtrohet kompetenca e zhvlerësimit ose e konvertimit të instrumenteve të kapitalit, çdo humbje në aktivet e bankës njihet plotësisht sipas skenarëve të veprimeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të marra në konsideratë.
5. Kur vlerat e vlerësimit ndryshojnë ndjeshëm nga vlerat e paraqitura nga banka në pasqyrat e saj financiare, vlerësuesi përdor supozimet e tij të vlerësimit, për përshtatjen e supozimeve dhe të politikave kontabël të nevojshme për përgatitjen e një bilanci të përditësuar, sipas shkronjës "a", pika 6, neni 24 të ligjit nr.133/2016, në përputhje me kuadrin në fuqi të kontabilitetit. Për sa i përket humbjeve të identifikuar nga vlerësuesi, të cilat nuk mund të njihen në bilancin e përditësuar, vlerësuesi specifikon shumën dhe përshkruan arsyet për përcaktimin e humbjeve, rrethanat dhe periudhën kohore se kur kanë ndodhur ato.
6. Kur instrumentet e kapitalit apo detyrimet e tjera konvertohen në kapital aksionar, vlerësuesi paraqet një vlerësim të vlerës së kapitalit aksionar pas konvertimit të aksioneve të reja të transferuara ose të emetuara, duke mbajtur në konsideratë zotëruesit e instrumenteve të kapitalit të konvertuar apo kreditorëve të tjerë. Ky vlerësim do të shërbejë si bazë për përcaktimin e normës apo normave të konvertimit të detyrimeve në kapital, sipas nenit 37 të ligjit nr.133/2016.

Neni 19 Përzgjedhja e bazës së matjes

1. Në përzgjedhjen e bazës apo bazave më të përshtatshme të matjes, vlerësuesi merr në konsideratë tërësinë e veprimeve të ndërhyrjes

së jashtëzakonshme që shqyrtohen sipas pikës 2, neni 18 të kësaj rregulloreje.

2. Vlerësuesi përcakton flukset e mjeteve monetare që banka mund të presë në bazë të supozimeve të drejta, të kujdesshme dhe realiste, për aktivet dhe detyrimet ekzistuese, të skontuara sipas një norme të përshtatshme sipas pikës 7, sipas zbatimit të veprimit ose veprimeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.
3. Flukset e mjeteve monetare duhet të përcaktohen në nivelin e duhur të agregimit, duke filluar nga aktivet dhe detyrimet individuale deri tek portofolet ose bizneset, duke marrë në konsideratë dallimet në profilet e rrezikut.
4. Kur veprimet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme të përmendura në pikën 2, neni 18 në këtë rregullore, kërkojnë që aktivet dhe detyrimet të mbahen nga një bankë që do të vijojë aktivitetin edhe në të ardhmen, vlerësuesi përdor vlerën e mbajtjes si bazë të përshtatshme të matjes. Vlera e mbajtjes, nëse konsiderohet e drejtë, e kujdesshme dhe reale, parashikon një normalizim të kushteve të tregut.
5. Vlera e mbajtjes nuk do të përdoret si bazë e matjes kur aktivet, të drejtat dhe detyrimet e bankës transferohen në një shoqëri të administrimit të aktiveve, sipas nenit 29 të ligjit nr.133/2016, në një bankë urë sipas nenit 28 të këtij ligji ose në rastin e shitjes së aktivitetit tregtar sipas nenit 26 të këtij ligji.
6. Kur veprimet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme të përmendura në pikën 2, neni 18 të kësaj rregullore parashikojnë shitjen e aktiveve, flukset monetare të pritura duhet të korrespondojnë me vlerat e mbetura për nxjerrje jashtë përdorimi, të parashikuara për t'u depozituar në të ardhmen.
7. Normat e skontimit përcaktohen duke marrë në konsideratë kohën e flukseve të mjeteve monetare, profilin e rrezikut, kostot e financimit dhe kushtet e tregut siç është e përshtatshme për aktivin ose detyrimin që matet, strategjinë për periudhën e shitjes së aktiveve si dhe pozicionin financiar të bankës pas ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Neni 20

Faktorë të veçantë në lidhje me vlerësimin dhe skontimin e flukseve të pritshme të parasë

1. Me qëllim vlerësimin e flukseve të mjeteve monetare, vlerësuesi zbaton gjykimin ekspert në përcaktimin e karakteristikave kryesore të aktiveve ose detyrimeve që vlerësohen. Gjithashtu, vlerësuesi zbaton gjykimin ekspert për të përcaktuar se si ndikon në këto flukse monetare vazhdimi, rinovimi i mundshëm ose rifinancimi, rrjedhja ose asgjësimi i këtyre aktiveve ose detyrimeve, siç parashikohet në veprimet për ndërhyrjen e jashtëzakonshme.

2. Kur veprimi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme parashikon që banka të mbajë aktive dhe detyrime ose të vijojë aktivitetin e biznesit, vlerësuesi mund të marrë në konsideratë faktorët që mund të ndikojnë në flukset e ardhshme të mjeteve monetare, përfshirë këtu:
 - a. ndryshimet në supozimet ose pritjet, në krahasim me ato që mbizotërojnë në datën e vlerësimit, në përputhje me prirjet historike afatgjata dhe një parashikim të arsyeshëm në përputhje me periudhën e parashikuar të mbajtjes të aktiveve ose për rimëkëmbjen e bankës; ose
 - b. bazat ose metodologjitë shtesë ose alternative të vlerësimit që konsiderohen të përshtatshme nga vlerësuesi dhe në përputhje me këtë rregullore, duke përfshirë në kontekstin e vlerësimit, vlerën e aksioneve pas konvertimit në kapital.
3. Sa i përket grupeve të aktiveve dhe detyrimeve ose aktiviteteve tregtare të parashikuara për të dalë jashtë përdorimit, vlerësuesi duhet të marrë parasysh shpenzimet dhe përfitimet e nxjerrjes jashtë përdorimit.
4. Kur situata është e tillë që e pengon bankën të mbajë një aktiv ose të vazhdojë një aktivitet tregtar ose kur shitja konsiderohet e nevojshme nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për arritjen e objektivave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, flukset e pritshme të parasë duhet t'u referohen vlerave të mbetura që priten brenda periudhës gjatë së cilës shitet aktivi.
5. Vlera e mbetur për nxjerrje jashtë përdorimi përcaktohet nga vlerësuesi në bazë të flukseve të parasë, të netuara me koston për nxjerrje jashtë përdorimi dhe të netuara me vlerën e pritshme të çdo garancie të dhënë, që mund të pritet në mënyrë të arsyeshme nga banka në kushtet aktuale të tregut, përmes shitjes ose transferimit të aktiveve apo detyrimeve. Në rast se është e përshtatshme, duke marrë në konsideratë veprimet që duhet të ndërmerren sipas skemës së ndërhyrjes së jashtëzakonshme, vlerësuesi mund të përcaktojë vlerën e mbetur për nxjerrje jashtë përdorimi, duke zbatuar një zbritje për një rënie të shpejtë të mundshme në çmimin e tregut. Për të përcaktuar vlerën e mbetur për nxjerrje jashtë përdorimi të aktiveve që nuk kanë një treg likuid, vlerësuesi merr në konsideratë çmimet në tregjet e vëzhguara ku tregtohen aktive të ngjashme ose vlerat e gjeneruara nga modelet financiare duke përdorur parametrat e tregut të vëzhguar dhe duke reflektuar zbritjet e nevojshme që rrjedhin nga mungesa e tregut likuid.
6. Vlerësuesi merr në konsideratë faktorët që mund të ndikojnë në vlerën e mbetur për nxjerrje jashtë përdorimi dhe periudhën e mbetur, duke përfshirë sa vijon:
 - a. vlerën e mbetur për nxjerrje jashtë përdorimi dhe periudhën e mbetur të vëzhguar në transaksione të ngjashme, të përshtatura për të marrë në konsideratë dallimet në modelin e biznesit dhe në strukturën financiare të palëve në transaksione;

- b. avantazhet ose disavantazhet e një transaksioni të veçantë që janë specifike për palët e përfshira, ose për një pjesë të pjesëmarrësve të tregut;
 - c. karakteristika të veçanta të një aktivi ose aktiviteti tregtar që mund të jenë të lidhura vetëm me një blerës potencial ose me një pjesë të pjesëmarrësve të tregut;
 - d. ndikimin e mundshëm të shitjeve të pritshme në vlerën e franshizës së bankës.
7. Kur vlerësohet vlera e aktivitetit tregtar për qëllime të instrumentit të shitjes së aktivitetit tregtar ose të bankës urë, vlerësuesi mund të marrë në konsideratë pritjet e arsyeshme për vlerën e franshizës. Një pritshmëri e tillë për vlerën e franshizës përfshin vlerën që rezulton nga një rinovim i aktiveve, nga rifinancimi i portofolit të hapur ose nga vazhdimi apo rifillimi i aktivitetit tregtar në kontekstin e veprimeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.
8. Në rast se vlerësuesi vlerëson se nuk ka asnjë mundësi reale për nxjerrjen jashtë përdorimit të një aktivi ose aktiviteti tregtar, nuk duhet të përcaktojë vlerën e nxjerrjes jashtë përdorimit, por duhet të vlerësojë flukset monetare përkatëse në bazë të perspektivave përkatëse për vazhdimin ose zvogëlimin e aktivitetit ose tkurrjen e aktivitetit tregtar. Kjo dispozitë nuk zbatohet për instrumentin e ndarjes së aktiveve ose të shitjes së aktivitetit tregtar.
9. Për pjesët e një grupi të aktiveve ose të një aktiviteti tregtar që ka të ngjarë të likuidohet sipas procedurave të likuidimit të detyruar, vlerësuesi mund të marrë në konsideratë vlerën e mbetur për nxjerrje jashtë përdorimi dhe periudhat e vëzhguara në ankandet e shitjeve që përfshijnë aktive me natyrë dhe gjendje të ngjashme. Përcaktimi i flukseve të pritshme të mjeteve monetare merr në konsideratë gjendjen jolikuide, mungesën e të dhënave të besueshme për përcaktimin e vlerave të nxjerrjes jashtë përdorimit dhe metodologjitë e vlerësimit të bazuara në të dhëna të pavëzhguara.

Neni 21 Vlerësimi i përkohshëm

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme ose vlerësuesi mund të kryejë vlerësim të përkohshëm sipas pikës 2 dhe 8, neni 24 të ligjit 133/2016, i cili kryhet në përputhje me dispozitat e përmendura në pikat 1, 3, 5 dhe 6 të nenit 24 të këtij ligji, për aq sa është e mundur duke marrë parasysh rrethanat emergjente të veprimit dhe rrethanat e tjera që justifikojnë kryerjen e këtij vlerësimi.
2. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme ose vlerësuesi përfshin një rezervë për mbulimin e humbjeve shtesë në vlerësimin e përkohshëm të aktiveve dhe detyrimeve të një banke, nëse humbjet e tilla mund të priten, bazuar në fakte dhe rrethana të njohura.

3. Rezervat për mbulimin e humbjeve përcaktohen në bazë të standardeve të njohura gjerësisht, të përdorura për të përcaktuar vlerën e aktiveve, ku të dhënat për humbjet e përcaktuara për një lloj aktivi mund të aplikohen në lloje të tjera të aktiveve me rregullime të mundshme.

Neni 22

Metodologjia për llogaritjen dhe përfshirjen e një rezerve për humbjet shtesë

1. Për shkak të pasigurisë në vlerësimin e përkohshëm të kryer në përputhje me shkronjat "b" deri në "e" të pikës 5, neni 24 në ligjin nr. 133/2016, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme ose vlerësuesi përfshin një rezervë për humbjet shtesë, me synimin për të reflektuar në vlerësim fakte dhe rrethana që mbështesin praninë e humbjeve shtesë me madhësi apo në një periudhë kohore të panjohur. Për shmangien e llogaritjes së shumëfishtë të pasigurive, vlerësuesi shpjegon dhe arsyeton supozimet në bazë të të cilave është përcaktuar mundësia për praninë e humbjeve shtesë.
2. Për të përcaktuar madhësinë e rezervës për humbjet shtesë, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme ose vlerësuesi identifikon faktorët që mund të ndikojnë fluksin e pritshëm monetar si rezultat i zbatimit të veprimeve dhe masave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme që mund të zbatohen.
3. Për qëllimet e pikës 2, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme ose vlerësuesi mund të ekstrapolojë humbjet e vlerësuara për një pjesë të aktiveve të bankës në pjesën e mbetur të bilancit të saj. Aty ku është e disponueshme, humbjet mesatare të vlerësuara për aktivet e pjesëmarrësve të ngjashëm të tregut mund të ekstrapolohen, duke iu nënshtruar përshtatjeve të nevojshme të dallimeve në modelin e biznesit dhe strukturën financiare.

KREU VI

VLERËSIMI PAS NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME

Neni 23

Kritere kryesore

1. Për të përcaktuar mënyrën e trajtimit të aksionarëve dhe kreditorëve në rast se do të kishte filluar procedura e likuidimit të detyruar, vlerësimi bazohet vetëm në informacionin rreth fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë dhe që njiheshin në mënyrë të arsyeshme në datën e marrjes së vendimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, të cilat në rast se do të ishin njohur, do të ndikonin në vlerën e aktiveve dhe detyrimeve të bankës në atë datë.
2. Për qëllime të përcaktimit të trajtimit aktual të aksionarëve dhe të kreditorëve në ndërhyrje të jashtëzakonshme, vlerësuesi mbështetet në informacionin

në dispozicion në lidhje me faktet dhe rrethanat që ekzistojnë në datën aktuale të trajtimit ose datat në të cilat aksionarët dhe kreditorët marrin kompensim.

3. Data e referencës së vlerësimit është data e vendimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, e cila mund të ndryshojë nga data aktuale e trajtimit. Kur vlerësuesi konsideron si të papërfillshëm ndikimin në të ardhurat e skontuara, të ardhurat e paskontuara në datën kur është zbatuar ndërhyrja e jashtëzakonshme mund të krahasohen drejtpërdrejt me shumën e skontuar të të ardhurave hipotetike që aksionarët dhe kreditorët do të kishin marrë nëse banka do t'i nënshtrohej procedurave të likuidimit të detyruar në datën e vendimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Neni 24 **Inventarizimi i aktiveve dhe detyrimeve**

1. Vlerësuesi krijon një listë të të gjitha aktiveve ose pronave të identifikuara dhe të kushtëzuara në pronësi të bankës. Kjo listë përfshin aktivet, për të cilat priten hyrje të mjeteve monetare në të ardhmen.
2. Banka i paraqet vlerësuesit një listë të të gjitha pretendimeve aktuale dhe atyre të kushtëzuara ndaj bankës. Kjo listë klasifikon të gjitha detyrimet dhe pretendimet e mundshme sipas niveleve të përparësisë në procedurat e likuidimit të detyruar. Vlerësuesi mund të hyjë në marrëveshje për këshillim ose ekspertizë të specializuar në lidhje me renditjen e detyrimeve që do të aplikoheshin në rastin e likuidimit të detyruar.
3. Vlerësuesi identifikon veçmas aktivet e barrësuara dhe detyrimet e siguruara nga këto aktive.

Neni 25 **Hapat e vlerësimit**

Për qëllimet e përcaktimit nëse ekziston dallim në trajtim sipas pikës 2, neni 57 të ligjit nr. 133/2016, vlerësuesi vlerëson:

- a. trajtimin që do të kishin marrë aksionarët dhe kreditorët e bankës si dhe skemat përkatëse të sigurimit të depozitave, nëse banka në procedurën e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, për të cilën është kryer veprimi ose veprimet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, do t'i ishte nënshtuar likuidimit të detyruar në kohën kur është marrë vendimi për ndërhyrjen e jashtëzakonshme, pa marrë në konsideratë mbështetjen në financimin e jashtëzakonshëm publik;
- b. ndikimin aktual që kanë marrë aksionarët dhe kreditorët e bankës në procedurën e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, vlerën e pretendimeve të ristrukturuara pas zbatimit të instrumentit të rikapitalizimit nga brenda ose instrumenteve të tjera të ndërhyrjes së jashtëzakonshme ose të të ardhurave të tjera të marra nga aksionarët dhe kreditorët në datën ose datat aktuale të trajtimit, të skontuara deri në datën e vendimit të

ndërhyrjes së jashtëzakonshme, nëse konsiderohet e nevojshme për të mundësuar një krahasim të drejtë me trajtimin e përmendur në shkronjën "a";

- c. nëse rezultati i trajtimit në shkronjën "a" është më i madh se rezultati i trajtimit në shkronjën "b" për secilin kreditor, në përputhje me nivelet e hierarkisë që zbatohen në procedurat e likuidimit të detyruar të identifikuar sipas nenit 24 në këtë rregullore.

Neni 26

Përcaktimi i trajtimit të aksionarëve dhe kreditorëve në procedurat e likuidimit të detyruar

1. Metodologjia për kryerjen e vlerësimit në përputhje me shkronjën "a", neni 25 në këtë rregullore, kufizohet në përcaktimin e shumës së skontuar të flukseve monetare të pritshme sipas procedurave të likuidimit të detyruar.
2. Flukset e pritshme të parasë skontohen me normën ose normat që pasqyrojnë sipas rastit, kohën e lidhur me flukset e pritshme të parasë, rrethanat mbizotëruese në datën e marrjes së vendimit për ndërhyrjen e jashtëzakonshme, normat pa rrezik të interesit, çmimin e rrezikut për instrumente financiare të ngjashme të emetuara nga banka të ngjashme, kushtet e tregut ose normat e skontimit të zbatuara nga blerësit potencialë dhe karakteristika të tjera të rëndësishme të elementit ose elementeve që vlerësohen.
3. Gjatë përcaktimit të shumës së skontuar të flukseve monetare të pritshme sipas procedurave të likuidimit të detyruar, vlerësuesi merr në konsideratë sa më poshtë:
 - a. legjislacionin dhe praktikën e përdorur në likuidimin e detyruar në juridiksionin përkatës, të cilat mund të ndikojnë faktorë të tillë si periudhat e pritshme të nxjerrjes jashtë përdorimit ose normat e rikuperimit;
 - b. administrimin e arsyeshëm të parashikueshëm, transaksionet, mirëmbajtjen, nxjerrjen jashtë përdorimit dhe kostot e tjera që do të shkaktoshin nga një administrator ose likuidator, si dhe shpenzimet e financimit;
 - c. informacionin mbi rastet më të fundit të likuidimeve të bankave të ngjashme, aty ku janë të disponueshme dhe të rëndësishme.
4. Për aktivet e tregtuara në një treg aktiv, vlerësuesi përdor çmimin e vëzhguar (të tregut), përveç rasteve kur rrethanat specifike siç janë përqendrimi dhe mbingopja e tregut, pengojnë tregtueshmërinë e aktiveve të bankës.
5. Për aktivet që nuk tregtohen në një treg aktiv, gjatë përcaktimit të shumës dhe kohës së flukseve të pritshme të mjeteve monetare, vlerësuesi merr në konsideratë një numër faktorësh duke përfshirë:
 - a. çmimet e vëzhguara në tregje aktive, ku tregtohen aktive të ngjashme;
 - b. çmimet e vëzhguara në procedurat e likuidimit ose transaksione të tjera që përfshijnë aktive me natyrë dhe kushte të ngjashme;
 - c. çmimet e vëzhguara në transaksionet që përfshijnë shitjen e aktivitetit

- të biznesit ose transferimin në një bankë urë ose në një shoqëri për administrimin e aktiveve në kuadër të ndërhyrjes së jashtëzakonshme që lidhet me subjekte të ngjashme;
- d. mundësinë që një aktiv të gjenerojë flukse monetare neto në procedurat e likuidimit të detyruar;
 - e. kushtet e pritshme të tregut brenda një periudhe të caktuar pritjeje, duke përfshirë kompleksitetin dhe aftësinë e tregut për të realizuar shkëmbimin e vëllimit përkatës të aktiveve brenda asaj periudhe; dhe
 - f. kohëzgjatjen e periudhës për nxjerrjen jashtë përdorimit, e cila duhet të pasqyrojë implikimet e ligjit dhe procedurave të likuidimit të detyruar, që përfshin kohëzgjatjen e pritshme të procesit të likuidimit ose karakteristikat e aktiveve përkatëse.
6. Vlerësuesi duhet të shqyrtojë nëse gjendja financiare e bankës do të kishte ndikuar në flukset e pritshme monetare, duke përfshirë kufizimet mbi aftësinë e administratorit për të negociuar kushtet me blerësit potencialë.
 7. Kur është e mundur dhe në varësi të çfarëdo dispozite të zbatueshme të likuidimit të detyruar, flukset monetare duhet të pasqyrojnë të drejtat kontraktuale, statutoare ose të drejta të tjera ligjore të kreditorëve ose praktika të likuidimit të detyruar.
 8. Të ardhurat hipotetike që rrjedhin nga vlerësimi do t'u shpërndahen aksionerëve dhe kreditorëve në përputhje me hierarkinë e tyre në rast se do të zbatoheshin likuidimi i detyruar, siç parashikohet në nenin 25 të kësaj rregulloreje.
 9. Me qëllim përcaktimit të shumës së pasiguarar të pretendimeve të derivativëve në procedurën e likuidimit të detyruar, vlerësuesi zbaton metodologjitë e përcaktuara në Kreun e VII të kësaj rregulloreje.

Neni 27

Përcaktimi i trajtimit aktual të aksionarëve dhe kreditorëve në ndërhyrjen e jashtëzakonshme

1. Vlerësuesi identifikon të gjitha pretendimet e mbetura pas zhvlerësimit ose konvertimit të instrumenteve të kapitalit dhe zbatimit të çfarëdo veprimi të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe ua përcakton këto pretendime personave juridikë dhe fizikë, të cilët ishin aksionarët dhe kreditorët e bankës në datën e vendimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Me përjashtim të rasteve kur personat juridikë dhe fizikë të cilët kanë qenë aksionarë dhe kreditorë të bankës në datën e vendimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, të cilët marrin kompensim në para si rezultat i ndërhyrjes së jashtëzakonshme, vlerësuesi përcakton trajtimin e tyre aktual në përputhje me këtë nen.
2. Kur personat juridikë dhe fizikë, të cilët ishin aksionarë dhe kreditorë të bankës në datën e vendimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme marrin

kompensim në kapital, si rezultat i ndërhyrjes së jashtëzakonshme, vlerësuesi përcakton trajtimin e tyre aktual duke dhënë një vlerësim të vlerës së përgjithshme të aksioneve të transferuara ose të emetuara për mbajtësit e instrumenteve të kapitalit të konvertuar ose kreditorët ndaj të cilëve është zbatuar rikapitalizimi nga brenda.

3. Për aksionet e përmendura në pikën 2, vlerësimi bazohet në vlerën që rrjedh nga metodologjitë e vlerësimit të pranuarra gjerësisht.
4. Kur personat juridikë dhe fizikë, të cilët janë aksionarët dhe kreditorët e bankës në datën e vendimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, marrin kompensim në tituj borxhi si rezultat i ndërhyrjes së jashtëzakonshme, vlerësuesi përcakton trajtimin aktual duke marrë në konsideratë faktorët që lidhen me ndryshimet në flukset e mjeteve monetare kontraktuale që rezultojnë nga zhvlerësimi ose konvertimi, ose zbatimi i veprimeve të tjera të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, si dhe norma përkatëse e skontimit.
5. Për çdo pretendim të papaguar, vlerësuesi mund të marrë në konsideratë, kur është e mundur dhe së bashku me faktorët e përshkruar në pikat 2 dhe 3, çmimet e vëzhguara në tregje aktive për instrumente të njëjta ose të ngjashme të emetuara nga banka në ndërhyrje të jashtëzakonshme ose banka të tjera të ngjashme.

Neni 28 Raporti i vlerësimit

Vlerësuesi përgatit një raport vlerësimi për Autoritetin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, i cili përfshin të paktën elementet e mëposhtme:

- a. një përmbledhje të vlerësimit, duke përfshirë paraqitjen e intervaleve të vlerave dhe burimet e pasigurisë së vlerësimit;
- b. një shpjegim të metodologjive dhe supozimeve kryesore të miratuara, si dhe ndjeshmërinë e vlerësimit ndaj këtyre zgjedhjeve;
- c. një shpjegim, kur është e mundur, pse vlerësimi ndryshon nga vlerësimet e tjera përkatëse, duke përfshirë vlerësimet para ndërhyrjes së jashtëzakonshme të kryera në përputhje me Kreun III të kësaj rregulloreje ose vlerësime të tjera rregullatore ose kontabël.

KREU VII VLERËSIMI I DERIVATËVE

Neni 29 Krahasimi ndërmjet rënies së vlerës që rrjedh nga dispozita *close-out* dhe mundësia për zbatimin e rikapitalizimit nga brenda ndaj kontratave derivative

1. Për qëllimet e shkronjës "c", pika 5, neni 36 të ligjit nr. 133/2016, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme krahason sa vijon:

- a. shumën e humbjeve që lindin/krijohen nga kontratat derivative në rikapitalizimin nga brenda, që llogaritet duke shumëzuar:
- i. pjesën ndërmjet të gjitha detyrimeve të renditura në mënyrë të barabartë, të detyrimeve që rrjedhin nga kontratat derivative si pjesë e vlerësimit sipas nenit 24 të ligjit nr.133/2016 dhe që nuk përfshihen në rastet përjashtimore të rikapitalizimit nga brenda në përputhje me pikën 2, neni 31 të këtij ligji,
me
 - ii. humbjet totale që priten të lindin nga të gjitha detyrimet që renditen në mënyrë të barabartë me derivativët, duke përfshirë detyrimet derivative që rrjedhin nga përfundimi i kontratës;
me
- b. rënien në vlerë bazuar në vlerësimin e shumës së kostove, shpenzimeve ose përkeqësimeve të tjera të vlerës që priten të ndodhin si pasojë e përfundimit të kontratave derivative, e cila përftohet duke llogaritur shumën e elementeve të mëposhtme:
- i. rreziku i rritjes së pretendimit të kundërpartisë në përfundim të kontratës, që vjen si rezultat i kostove të rimbrotjes që priten t'i shkaktohen kundërpartisë, duke marrë në konsideratë diferencat mes çmimit të blerjes dhe të shitjes, çmimit mesatar të blerjes dhe shitjes me çmimin e blerjes dhe të shitjes në përputhje me shkronjën "b", pika 2, neni 33 në këtë rregullore;
 - ii. shpenzimet/kostot që priten t'i shkaktohen bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme për rivendosjen e një pozicioni të ngjashëm tregtimi në derivativë, të nevojshëm për rimbrotjen ndaj çdo ekspozimi të hapur ose për ruajtjen e një profili rreziku të pranueshëm, në përputhje me strategjinë e ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Krijimi i një pozicioni të ngjashëm derivativësh mund të arrihet duke marrë parasysh kërkesat e marzhit fillestar dhe diferencën mes çmimit të blerjes dhe të shitjes që mbizotëron në treg;
 - iii. çdo reduktim në vlerën e franshizës që rrjedh nga përfundimi i kontratave derivative, duke përfshirë përkeqësimin e vlerësimit për aktivet e tjera ose ato të lidhura me kontratat derivative që përfundojnë, dhe çdo ndikim në kostot e financimit ose nivelet e të ardhurave;
 - iv. çdo rezervë parandaluese ndaj implikimeve të mundshme negative nga mbyllja (*close-out*), të tilla si gabimet dhe mosmarrëveshjet në lidhje me transaksionet ose shkëmbimin e kolateralit.
2. Krahasimi sipas pikës 1 kryhet përpara se të merret vendimi për përfundimin e kontratave derivative, si pjesë e vlerësimit për të informuar vendimet për veprimet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme sipas nenit 24 të ligjit nr. 133/2016. Ky krahasim kryhet sipas kërkesave të përcaktuara në këtë rregullore.

Neni 30

Komunikimi i vendimit për përfundimin dhe kompensimin e marrëveshjeve mbi produktet derivative

1. Përpara ushtrimit të kompetencave të zhvlerësimit dhe konvertimit në lidhje me detyrimet që rrjedhin nga kontratat e produkteve derivative, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme u njofton palëve kontraktuese vendimin për përfundimin e kontratave sipas shkronjës "g", pika 1, neni 47 të ligjit nr. 133/2016.
2. Vendimi për përfundimin e kontratave derivative hyn në fuqi menjëherë ose në një datë të mëvonshme të përcaktuar në njoftim.
3. Në vendimin e përmendur në pikën 1, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme specifikon datën dhe kohën në të cilën palët mund të paraqesin pranë Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, një transaksion zëvendësues të arsyeshëm në terma tregu me qëllim përcaktimin e shumës së përfundimit të kontratës, sipas pikës 1, neni 33 në këtë rregullore. Pala tjetër duhet, gjithashtu, t'i ofrojë Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme një përmbledhje të të gjitha transaksioneve zëvendësuese të arsyeshme në terma tregu.
4. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme mund të ndryshojë datën dhe kohën në të cilën palët raportojnë të dhënat për transaksionet zëvendësuese të arsyeshme në terma tregu. Çdo vendim për të ndryshuar datën dhe kohën në të cilën palët mund të ofrojnë të dhëna për transaksionet zëvendësuese të arsyeshme në terma tregu, duhet t'i komunikohet palës tjetër.
5. Në vendimin e përmendur në pikën 1, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme mund të specifikojë kriteret që synon të zbatojë gjatë vlerësimit nëse transaksioni zëvendësues është i arsyeshëm në terma tregu.

Neni 31

Roli i marrëveshjes së kompensimit *netting*

Për kontratat që i nënshtrohen një marrëveshjeje kompensimi *netting*, vlerësuesi përcakton në përputhje me nenet 29, 32 dhe 33 në këtë rregullore, një shumë të vetme që banka në ndërhyrje të jashtëzakonshme ka të drejtën ligjore për të marrë ose detyrimin ligjor për të paguar, si rezultat i përfundimit të kontratës për të gjitha kontratat derivative në paketën *netting*, siç përcaktohet në marrëveshjen *netting*.

Neni 32

Parimet e vlerësimit të shumës për përfundimin e parakohshëm

1. Vlerësuesi përcakton vlerën e detyrimeve që rrjedhin nga kontratat derivative si shumë e përfundimit të parakohshëm, e llogaritur si shumatore e elementeve të mëposhtme:

- a. shumat e papaguara, kolaterali ose shumat e tjera që duhet të paguhen nga banka në ndërhyrje të jashtëzakonshme ndaj palës tjetër, nga të cilat zbriten shumat e papaguara, kolaterali dhe shumat e tjera që duhet t'i paguhen bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme nga pala tjetër në datën e përfundimit;
 - b. shuma e përfundimit që mbulon shumën e humbjeve ose kostove që shkaktohen nga palët e kontratave derivative, ose fitimet e realizuara prej tyre, duke zëvendësuar ose marrë ekuivalentin ekonomik në terma materiale të kontratave të ndërprera dhe të drejtat e opsionit të palëve në lidhje me ato kontrata.
2. Për qëllimet e pikës 1, shumat e papaguara në lidhje me përfundimin e kontratave derivative, janë:
- a. shumat që bëhen të pagueshme në ose para datës së përfundimit të kontratës dhe që mbeten të papaguara në atë datë;
 - b. një shumë e barabartë me vlerën e drejtë të tregut të aktivitetit që kërkohej të lëvrohet për çdo detyrim të kontratave derivative, që kërkohej të shlyheshin me dorëzim në ose para datës së përfundimit të kontratës dhe që nuk janë shlyer ende në datën e përfundimit të kontratës;
 - c. shuma e interesit ose kompensimit të përlogaritur për periudhën nga data kur duhej bërë pagesa ose duhej dorëzuar aktivi deri në datën e përfundimit (*close-out*).

Neni 33

Përcaktimi i shumës së përfundimit të kontratës

1. Kur një kundërpalë ofron prova/dëshmi për transaksione zëvendësuese të arsyeshme me kushte tregu brenda afatit të përcaktuar në pikën 3, neni 30 në këtë rregullore, vlerësuesi përcakton shumën e përfundimit, duke u bazuar në çmimet e transaksioneve zëvendësuese.
2. Kur një kundërpalë nuk ofron prova/dëshmi për transaksione zëvendësuese të arsyeshme me kushte tregu brenda afatit të përcaktuar në pikën 3, neni 30 në këtë rregullore dhe/ose kur vlerësuesi gjykon se transaksionet zëvendësuese të ofruara nuk janë brenda kushteve që dikton tregu, si dhe në rastet kur zbatohet pika 2, neni 34 në këtë rregullore, vlerësuesi përcakton sa do të jetë shuma e përfundimit, duke u bazuar në sa më poshtë:
 - a. çmimet mesatare të tregut në fund të ditës, në përputhje me proceset e zakonshme të biznesit të bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme në datën e përcaktuar sipas pikës 2, neni 11 në këtë rregullore;
 - b. diferencën ndërmjet çmimit mesatar dhe çmimit në blerje ose diferencën ndërmjet çmimit mesatar dhe çmimit në shitje, në varësi të kahut të pozicionit neto të rrezikut;
 - c. rregullimet e çmimeve dhe diferencave të përmendura në shkronjat "a" dhe "b" të kësaj pike, aty ku është e nevojshme për të reflektuar likuiditetin e tregut për rreziqet ose instrumentet bazë dhe madhësinë e ekspozimit në raport me thellësinë e tregut, si dhe rrezikun e mundshëm të modelit.

3. Për sa i përket detyrimeve brenda grupit, vlerësuesi mund të përcaktojë vlerën duke përdorur çmimet mesatare të tregut në fund të ditës, siç referohet në shkronjën "a" të pikës 2, pa marrë parasysh shkronjat "b" dhe "c" të pikës 2, ku strategjia e ndërhyrjes së jashtëzakonshme do të nënkuptonte rimbrotjen e transaksioneve të përfunduara nëpërmjet një transaksioni derivativ ose grupi transaksionesh brenda grupit bankar.
4. Për përcaktimin e vlerës së përfundimit sipas pikës 2, vlerësuesi mban parasysh një gamë të plotë të burimeve të të dhënave të disponueshme dhe të besueshme, dhe mund të mbështetet në të dhëna tregu që gjenden lehtësisht ose në çmime teorike të krijuara nga modelet e vlerësimit që synojnë vlerësimin e vlerave, duke përfshirë burimet e mëposhtme të të dhënave:
 - a. të dhënat e ofruara nga palët e treta, siç mund të jenë të dhënat e tregut që gjenden lehtësisht ose të dhënat e parametrave të vlerësimit dhe kuotimet e aktorëve kryesorë të tregut;
 - b. për produktet e standardizuara, vlerësimet e krijuara nga sistemet e veta të vlerësuesit;
 - c. të dhënat e ofruara nga banka në ndërhyrje të jashtëzakonshme, të tilla si modelet e brendshme dhe vlerësimet, përfshirë verifikimet e pavarura të çmimeve;
 - d. të dhënat e ofruara nga palët e tjera, përveç të dhënave të transaksioneve zëvendësuese të raportuara në përputhje me pikën 3, neni 30 në këtë rregullore duke përfshirë të dhënat për mosmarrëveshjet aktuale ose të mëparshme të vlerësimit në lidhje me transaksione ose kuotime të ngjashme ose të lidhura;
 - e. çdo të dhënë tjetër të rëndësishme.
5. Për qëllim të shkronjës "b" të pikës 2, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme mund të udhëzojë bankën në ndërhyrje të jashtëzakonshme të kryejë një verifikim të pavarur të çmimeve në momentin kohor të përcaktuar në përputhje me pikën 2, neni 11 në këtë rregullore, duke përdorur informacionin në fund të ditës në datën e përfundimit të kontratës.

Neni 34

Vlerësimi i hershëm i vlerës së detyrimeve derivative

1. Vlerësuesi përcakton vlerën e detyrimeve derivative për momentin e përcaktuar sipas pikës 2, neni 11 në këtë rregullore.
2. Vlerësuesi mund të përcaktojë vlerën e detyrimeve që rrjedhin nga kontratat derivative, më herët nga momenti i përcaktuar në pikën 1, në kuadër të kryerjes së një vlerësimi të përkohshëm në përputhje me pikën 8, neni 24 të ligjit nr. 133/2016. Përcaktime të tilla të hershme bëhen në bazë të vlerësimeve të mbështetura në parimet sipas neneve 32 dhe 33 në këtë rregullore, si dhe në bazë të të dhënave të disponueshme në momentin e vlerësimit.

3. Kur vlerësuesi kryen një vlerësim të hershëm sipas pikës 2, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme mund t'i kërkojë në çdo kohë të përditësojë vlerësimin e përkohshëm, për të marrë në konsideratë zhvillimet përkatëse të tregut të vëzhguar ose dëshmitë e transaksioneve zëvendësuese të arsyeshme në terma tregu, të përfunduara në momentin e përcaktuar në përputhje me pikën 1. Këto zhvillime apo prova, nëse janë në dispozicion deri në datën dhe kohën e përcaktuar në përputhje me pikën 2, neni 30 në këtë rregullore, merren në konsideratë në vlerësimin *ex-post* përfundimtar të kryer në zbatim të pikës 10, neni 24 të ligjit nr. 133/2016.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS

GENT SEJKO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
GUVERNATORI

Nr. 2973 prot.

Tiranë, më 07.6.2019.

URDHËR
Nr.2973, datë 07.6.2019

PËR
HEDHJEN NË QARKULLIM TË MONEDHËS METALIKE SHQIPTARE, ME KURS
LIGJOR, ME VLERË NOMINALE 10 LEKË

Në bazë dhe për zbatim të nenit 36 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; të nenit 11 pika 6 të Statutit të Bankës së Shqipërisë, miratuar me vendimin nr. 90, datë 02.12.2015 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë; të vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 2, datë 10.1.2018 "Për rishtypjen e monedhës metalike shqiptare me kurs ligjor, me prerje 10 Lekë"; të nenit 17, të pikës 1, 2 dhe 3 të rregullores "Për shtypjen, rishtypjen, hedhjen dhe tërheqjen nga qarkullimi të kartëmonedhave dhe monedhave metalike shqiptare me kurs ligjor", miratuar me vendimin nr.133, datë 7.12.2016 të Këshillit Mbikëqyrës; si dhe bazuar në propozimin e Departamentit të Emisionit,

URDHËROJ:

1. Hedhjen në qarkullim të monedhës metalike shqiptare me kurs ligjor me vlerë nominale, 10 Lekë, emetim i vitit 2018, duke filluar nga data 25 qershor 2019.
2. Me zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Departamenti i Emisionit dhe Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës.
3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

GUVERNATOR

GENT SEJKO

**TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 21, NUMËR 1,
SHKURT 2019**

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 2, datë 9.1.2019, "Për disa ndryshime në rregulloren "Për kapitalin rregullator të bankës""
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 3, datë 9.1.2019, "Për miratimin e emërimit të drejtorit të Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës të bankës së Shqipërisë"
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 4, datë 9.1.2019, "Për emërimin e Zëvendësguvernatorit të Parë të Bankës së Shqipërisë"
4. Licencë nr. 44, datë 16.1.2019, "Për të vepruar si subjekt financiar jobankë në Republikën e Shqipërisë"
5. Licencë nr. 176, datë 01.2.2019, "Për të vepruar si shoqëri kursim-krediti në Republikën e Shqipërisë"
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 6, datë 6.2.2019, "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë"
7. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 8, datë 6.2.2019, "Për miratimin e delegimit të kompetencës për përfaqësimin ligjor të Bankës së Shqipërisë në Programin për Harmonizimin e Vrojtimeve të Besimit Konsumator dhe të Biznesit të Komisionit Evropian"
8. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 9, datë 6.2.2019, "Për dhënien e miratimit paraprak për kryerjen e veprimtarisë financiare shtesë nga Banka e Parë e Investimeve, Albania sh.a."
9. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 10, datë 6.2.2019, "Për shtypjen e kartëmonedhave shqiptare me kurs ligjor, prerja 1000 lekë"
10. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 11, datë 6.2.2019, "Për shtypjen e kartëmonedhave shqiptare me kurs ligjor, prerja 10.000 lekë"
11. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 13, datë 6.2.2019, "Për nxjerrjen jashtë përdorimit të disa vlerave materiale në Bankën e Shqipërisë dhe asgjësimin e tyre"
12. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 14, datë 6.2.2019, "Për miratimin e delegimit të kompetencës për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bankës së Shqipërisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, për vënien në dispozicion të Bankës së Shqipërisë të të dhënave për qëllime statistikore"
13. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 15, datë 6.2.2019, "Për miratimin e delegimit të kompetencës për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bankës së Shqipërisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit"
14. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 17, datë 6.2.2019, "Për dhënien e miratimit paraprak për zotërimin nga Balfin sh.p.k. të 88.95 për qind të kapitalit aksionar të Bankës Tirana sh.a."

**TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 21, NUMËR 2,
MARS 2019**

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 20, datë 13.3.2019, "Për dhënien e miratimit paraprak për zotërimin nga OTP Bank Nyrt, Hungari, të 88.89 për qind të kapitalit aksionar të Bankës Societe Generale Albania sh.a."
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 21, datë 13.3.2019, "Për dhënien e miratimit paraprak për zotërimin nga Banka Union sh.a., të 100 për qind të kapitalit aksionar të Bankës Ndërkombëtare Tregtare sh.a."
3. Vendim qarkullues i Këshillit Mbikëqyrës nr. 22, datë 19.3.2019 "Për miratimin e delegimit të kompetencës për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bankës së Shqipërisë dhe Deutsche Bundesbank "Mbi ofrimin e mbështetjes për programin e financuar nga Bashkimi Evropian të asistencës teknike të titulluar "Programi për forcimin e kapaciteteve të bankave qendrore në Ballkanin Perëndimor me fokus integrimin në Sistemin Evropian të Bankave Qendrore"
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 23, datë 28.3.2019, "Për emërimin e kryetarit dhe anëtarëve të Komitetit të Auditit të Bankës së Shqipërisë"
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 24, datë 28.3.2019, "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë"
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 25, datë 28.3.2019, "Për miratimin e pasqyrave financiare të Bankës së Shqipërisë për vitin 2018"
7. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 26, datë 28.3.2019, "Për miratimin e rregullores "Për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e operatorëve të sistemeve për shlyerjen e titujve"

**TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 21, NUMËR 3,
PRILL 2019**

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 27, datë 28.3.2019, "Për miratimin e rregullores "Për raportin e mbulimit me likuiditet"
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 29, datë 28.3.2019, "Për shtypjen e monedhave metalike përkujtimore, për qëllime numizmatike, në vitin 2019"
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 31, datë 3.4.2019, "Për miratimin e delegimit të kompetencës për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bankës së Shqipërisë dhe Tranzit Shpk dhe Societa per la Gestione di Attivita"
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 32, datë 3.4.2019, "Për një ndryshim në rregulloren "Për strukturën e pagave bazuar në klasifikimin e vendeve përkatëse të punës në Bankën e Shqipërisë"
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 33, datë 3.4.2019, "Për miratimin e rregullores "Për përcaktimin e nivelit të ushtrimit të kompetencave në Bankën e Shqipërisë për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka"



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BANKA E SHQIPËRISE
KESHILLI MBIKËQYRES

V E N D I M

NR. 54 DITE 13.07.2009

Banka e Shqipërisë
Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë
Tel: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419401/2/3
Faks: + 355 4 241 94 08
E-mail: public@bankofalbania.org
www.bankofalbania.org
Tirazhi: 200 kopje

MIRATIMIN E RR...
SHITBIJEREVE...
1,14,15,16,18, si...
1997 "Për Bankën e...
Këshilli Mbi...